



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 192

10 dhjetor

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 8419 datë 2.12.2013	Për një ndryshim në dekretin nr. 8389, datë 13.11.2013 “Për dhënie të shtetësisë shqiptare”..... 7933
Vendim i KM nr. 1036, datë 22.11.2013	Për miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në lidhje me grantet e investimit nga llogaria EU/IPA 2011 dhe llogaria EU/IPA 2010 për projektin e rrugëve rajonale dhe lokale..... 7933
Vendim i KM nr. 1049, datë 4.12.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar..... 7956
Udhëzim i MD dhe MF nr. 5668, datë 20.11.2013	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 13, datë 12.2.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimit Përmbarimor Shtetëror, Prokurorisë, Noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar..... 7970
Urdhër i MB nr. 1909, datë 17.10.2013	Për delegim kompetence..... 7871
Urdhër i MD nr. 765, datë 6.12.2013	Për rregullat e organizimit dhe funksionimit të komiteteve <i>ad hoc</i> 7972

DEKRET
Nr. 8419, datë 2.12.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË DEKRETIN NR. 8389, DATË 13.11.2013 “PËR DHËNIE TË
SHTETËSISË SHQIPTARE”**

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës së Shqipërisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Ndryshimin e pikës 1 të nenit 1 të dekretit nr. 8389, datë 13.11.2013 “Për dhënie të shtetësisë shqiptare”, nga “Christian Staoros Canacaris” në “Christian Stavros Canacaris”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 1036, datë 22.11.2013

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH),
NË LIDHJE ME GRANTET E INVESTIMIT NGA LLOGARIA EU/IPA 2011 DHE
LLOGARIA EU/IPA 2010 PËR PROJEKTIN E RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në lidhje me grantet e investimit nga llogaria EU/IPA 2011 dhe llogaria EU/IPA 2010 për projektin e rrugëve rajonale dhe lokale, me një grant prej 34 068 750 (tridhjetë e katër milionë e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) eurosh, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



(Numri i Veprimit 40153)

MARRËVESHJE GRANTI
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM NË LIDHJE ME GRANTET E INVESTIMIT NGA
LLOGARIA EU/IPA 2011 DHE LLOGARIA EU/IPA 2010 PËR PROJEKTIN E RRUGËVE
RAJONALE DHE LOKALE TË SHQIPËRISË

Datë _____

11-4-1-515

Marrëveshje Granti (Marrëveshja) e lidhur më _____ 2013 ndërmjet Republikës së Shqipërisë (më poshtë quhet “Përfituesi), e përfaqësuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (më poshtë quhet “Banka” ose “BERZH).

Ndërsa:

A. BERZH-i është një institucion financiar ndërkombëtar i themeluar sipas së drejtës ndërkombëtare në pajtim me Marrëveshjen themeluese të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Marrëveshja Themeluese e Bankës) e datës 29 maj 1990;

B. Më 4 mars 2010, Banka ka lidhur një marrëveshje huaje me Përfituesin në cilësinë e Huamarrësit, në pajtim me të cilën Banka si huadhënëse ka rënë dakord të japë një hua prej 50.000.000 eurosh (pesëdhjetë milionë eurosh) për financimin e një pjese të rehabilitimit të rrjetit rrugor rajonal dhe lokal të Shqipërisë, siç përshkruhet në Grafikon 1 (Projekti), në pajtim me termat dhe kushtet e parashikuara në marrëveshjen e huas që mund të ndryshohet herë pas here (Marrëveshja e Huas);

C. Banka autorizohet nëpërmjet nenit 20 të Marrëveshjes Themeluese të Bankës të lidhë dhe administrojë marrëveshje bashkëpunimi me çdo subjekt publik ose privat. Më tej, për sa më sipër, Banka dhe Bashkimi Evropian kanë lidhur një marrëveshje në datën 30 nëntor 2011, që mund të ndryshohet herë pas here (Marrëveshja IPA 2010), në pajtim me të cilën Banka menaxhon dhe administron fondet e bashkëpunimit të ofruara nga Bashkimi Evropian në një llogari (Llogaria IPA 2010). Banka dhe Bashkimi Evropian kanë lidhur një marrëveshje tjetër në datën 21 dhjetor 2011, që mund të ndryshohet herë pas here (Marrëveshja IPA 2011) në pajtim me të cilën Banka menaxhon dhe administron fondet e bashkëpunimit të ofruara nga Bashkimi Evropian në një llogari tjetër (Llogaria IPA 2011).

D. Banka ka rënë dakord t’i ofrojë Përfituesit grante nga Llogaria IPA 2010 dhe nga Llogaria IPA 2011, në pajtim me dhe sipas termave dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje. Përfituesi synon që pastaj t’i transferojë grantet nga llogaria IPA 2010 dhe nga llogaria IPA 2011, në Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) sipas termave që do të caktohen në një marrëveshje transferimi që duhet të lidhet ndërmjet Përfituesit dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Kështu bihet dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime; referenca dhe tituj

Seksioni 1.01

Përkufizime

Fjalët dhe shprehjet me germa kapitale në këtë Marrëveshje (duke përfshirë shtojcat dhe hyrjet), por që nuk janë përkufizuar këtu, kanë të njëjtin kuptim që u vishet atyre në Marrëveshjen e 7934

Huas, marrëveshjet mbështetëse të Projektit dhe/ose në Termat dhe Kushtet Standarde nëse përdoren në këtë Marrëveshje.

Nëse përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë shtojcat dhe hyrjen), përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

“Fondi Shqiptar i Zhvillimit ose “FSHZH” është agjencia ekzekutuese e këtij projekti në emër të Republikës së Shqipërisë.

“Marrëveshje Themeluese e Bankës” ka kuptimin e veshur asaj në Hyrjen A.

“Kontrata” janë kontratat e lidhura ose që do të lidhen me një Kontraktor, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, në lidhje me prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve përkatëse të Projektit, duke përfshirë Zërat e Financuara nga Granti dhe që duhet të financohen plotësisht ose pjesërisht nga Financimi i Grantit.

“Kontraktorët” janë kontraktorët që duhet të angazhohen në lidhje me prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve përkatëse për Projektin, duke përfshirë Zërat e Financuar nga Granti, ku çdo kontraktor i tillë duhet të zgjidhet në pajtim me Seksionin 3.04 (Prokurimi) të kësaj Marrëveshjeje dhe të pranohet nga Banka.

“Livrimi” është livrimi i çdo pjese të Grantit herë pas here në pajtim me Seksionin 2.02 (Livrimi) të kësaj Marrëveshjeje.

“Donator” është Bashkimi Evropian.

“Data e hyrjes në fuqi” është data në të cilën Marrëveshja hyn në fuqi në pajtim me Seksionin 7.01 (data e hyrjes në fuqi) të saj.

“Granti” është Granti IPA 2010 dhe Granti IPA 2011 së bashku.

“Kategoritë që financohen nga Granti” janë mallrat, punët dhe shërbimet përkatëse që duhet të financohen nga Granti, sipas përshkrimit të mëtejshëm në Grafikon 1 të kësaj Marrëveshjeje.

“Marrëveshja IPA 2010” ka kuptimin e veshur asaj në Hyrjen C.

“Llogaria IPA 2010” ka kuptimin e veshur asaj në Hyrjen C.

“Marrëveshja IPA 2011” ka kuptimin e veshur asaj në Hyrjen C.

“Llogaria IPA 2011” ka kuptimin e veshur asaj në Hyrjen C.

“Granti IPA 2010” ka kuptimin e veshur asaj sipas Seksionit 2.01 (shuma, monedha dhe qëllimi) të kësaj Marrëveshjeje.

“Granti IPA 2011” ka kuptimin e veshur asaj sipas Seksionit 2.01 (shuma, monedha dhe qëllimi) të kësaj Marrëveshjeje.

“Data e fundit e disponibilitetit të Grantit” është data e specifikuar në Seksionin 2.02(a) (data e fundit e disponibilitetit të Grantit) të kësaj Marrëveshjeje.

“Monitoruesi i Huadhënësit” është konsulenti i caktuar nga Banka për qëllimet e monitorimit të zbatimit të Projektit.

“Marrëveshja e Huas” ka kuptimin e veshur asaj në Hyrjen B.

“Financimi nëpërmjet Huas” është financimi i dhënë ose që duhet t’i ofrohet nga Banka Përfituesit në cilësinë e tij si Huamarrës sipas Marrëveshjes së Huas.

“Projekti” është Projekti i përshkruar në Shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje.

“Data e përfundimit të Projektit” është data në të cilën kanë ndodhur të gjitha sa më poshtë:

a) Përfituesi i ka paraqitur Bankës dhe monitoruesit të Huadhënësit një njoftim, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, të nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit, që vërteton që Projekti është përfunduar;

b) Banka ka marrë një vërtetim nga Monitoruesi i Huadhënësit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, që konfirmon pa asnjë rezervë të konsiderueshme, që Projekti ka përfunduar; dhe

c) Banka i ka paraqitur Përfituesit një njoftim që konfirmon që Banka është e bindur që Projekti ka përfunduar.



“Grupi Drejtues i Projektit” është grupi i drejtimit të projektit që përmendet në Seksionin 3.02(a)(3) të kësaj Marrëveshjeje.

“Përfituesi” është Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë.

“Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit” është Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë.

“Detyrimi për Rimbursim” është detyrimi i përmendur në Seksionin 2.03 (Detyrime të Kushtëzuara dhe të Pakushtëzuara për Rimbursim) të kësaj Marrëveshjeje, dhe mund të jetë “Detyrim Rimbursimi i kushtëzuar” ose një “Detyrim Rimbursimi i pakushtëzuar”, ku këta terma përdoren në këtë Seksion.

“Termet dhe Kushtet Standarde” janë Termet dhe Kushtet Standarde të BERZH-it të datës 1 dhjetor 2012.

Seksioni 1.02 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje:

- a) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe anasjellas, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe;
- b) titujt dhe përmbajtja futen vetëm për lehtësi referimi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje;
- c) fjalët që tregojnë personat përfshijnë korporatat, partneritetet dhe persona të tjerë juridikë dhe referencat të një person përfshin pasuesit dhe transferimet e lejueshme;
- d) referenca të një Nen, Seksion apo Shtojcë përkatëse, përveç kur thuhet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si një referencë në këtë Nen ose seksion apo Shtojcë përkatëse të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2 Financimi nga Granti

Seksioni 2.01 Shuma, monedha dhe qëllimi

a) Sipas dhe në pajtim me këtë Marrëveshje, Banka bie dakord t’i japë Përfituesit një Grant që përbëhet nga:

1. Granti IPA 2010 me një shumë maksimale prej 19,750,000 eurosh (nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë eurosh) dhe nga Llogaria IPA 2010; dhe

2. Granti IPA 2011 me një shumë maksimale prej 14,318,750 eurosh (katërmëdhjetë milionë e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë eurosh) nga Llogaria IPA 2011.

b) Granti do të jepet nga Banka vetëm për qëllimet e financimit të Zërave të Financuar nga Granti që duhet të prokurohen në pajtim me Seksionin 3.04 (Prokurimi) të kësaj Marrëveshjeje.

c) Në pajtim me Seksionin 5.05 (Ngjarjet e Shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje, Granti është i pashlyeshëm.

d) Njihet dhe pranohet shprehimisht që Banka nuk do të jetë e detyruar të bëjë ndonjë Livrim ose ndonjë pagesë tjetër sipas dhe/ose në pajtim me këtë marrëveshje, përveç në masën që një shumë në lidhje me të cilën, dhe të barabartë me të, ky Livrim ose kjo pagesë përkatësisht sipas Grantit IPA 2010 dhe/ose Grantin IPA 2011 është e disponueshme në Llogarinë IPA 2010 dhe/ose Llogarinë IPA 2011, përkatësisht, për këtë qëllim.

Seksioni 2.02 Livrimet

Në pajtim me Seksionin 5.01 (Pezullimi), Seksionin 5.02 (Anulimi) dhe Seksionin 7.02 (Kushtet Paraprake të Hyrjes në Fuqi) të kësaj Marrëveshjeje, Granti livrohet nga Banka herë pas here në një ose disa Livrime në pajtim me dispozitat e mëposhtme:

a) Data e Fundit e Disponibilitetit të Grantit

1. E drejta e Përfituesit për të kërkuar një Livrim sipas Grantit IPA 2010 në pajtim me këtë Marrëveshje hyn në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe pushon së qeni në fuqi në rastin më të parë të: i) data e fundit e disponibilitetit e caktuar në pajtim me Seksionin 2.02(f)(2) (Terma të Tjerë Financiarë të Huas) të Marrëveshjes së Huas; ose ii) 4 mars 2017; ose një datë tjetër e mëvonshme që Banka mund të caktojë në diskrecionin e saj dhe njofton Përfituesin.

2. E drejta e Përfituesit për të kërkuar një Livrim sipas Grantit IPA 2011 në pajtim me këtë Marrëveshje hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi dhe pushon së qeni në fuqi në rastin më të parë të: i) data e fundit e disponibilitetit e caktuar në pajtim me Seksionin 2.02(f)(2) (Terma të Tjerë Financiarë të Huas) të Marrëveshjes së Huas; ose ii) 4 mars 2017; ose një datë tjetër e mëvonshme që Banka mund të caktojë në diskrecionin e saj dhe njofton Përfituesin.

b) Shpenzime të Përshtatshme

Përveç kur Banka bie dakord ndryshe, Livrimet bëhen vetëm për të financuar:

1. shpenzimet e bëra (ose nëse bie dakord Banka që do të bëhen) në lidhje me koston e arsyeshme të Zërave të Financuar nga Granti; dhe

2. shpenzimet e bëra pas datës së kësaj Marrëveshjeje dhe para datës 4 mars 2017 ose një datë e mëvonshme që mund të caktojë Banka në diskrecionin e saj dhe njofton Përfituesin.

c) Kushtet e Livrimit

Pa kufizuar përgjithësimin e Seksionit 2.02 (Livrimet) të kësaj Marrëveshjeje:

1. Çdo Livrim sipas Grantit IPA 2010 u nënshtrohet kushteve që:

A. të gjitha kushtet paraprake të livrimit të Transhit A të Financimit të Huas sipas Seksionit 6.01 (Kushtet Paraprake të Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe Livrimit të Transhit A) të Marrëveshjes së Huas janë përmbushur në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën; dhe

B. shuma e plotë e Grantit IPA 2010 e livruar nga Banka nuk kalon në asnjë rast 39.5% të shumës së plotë të livruar më parë ose njëkohësisht sipas Marrëveshjes së Huas.

2. Çdo Livrim sipas Grantit IPA 2011 u nënshtrohet kushteve, që:

A. të gjitha kushtet paraprake të livrimit të Transhit B të Financimit të Huas sipas Seksionit 6.03 (Kushtet Paraprake të Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe Livrimit të Transhit B), përveç vetëm Seksionit 6.03(a), të Marrëveshjes së Huas janë përmbushur në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën; dhe

B. shuma e plotë e Grantit IPA 2011 e livruar nga Banka nuk kalon në asnjë rast 28.64% të shumës së plotë të livruar më parë ose njëkohësisht sipas Marrëveshjes së Huas.

d) Kërkesë livrimi

1. Përfituesi mund të kërkojë një Livrim duke i paraqitur Bankës një kërkesë origjinale për këtë Livrim, të nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit ose një person i caktuar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit. Çdo kërkesë për Livrim bëhet në formën e Shtojcës 1 (Forma e Kërkesës për Livrim) dhe i paraqitet Bankës të paktën pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune para datës së propozuar të vlerës së këtij Livrimi. Kjo Kërkesë, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, është e parevokueshme dhe detyruese për Përfituesin.

2. Çdo kërkesë për Livrim shoqërohet me ato dokumente ose prova të tjera që janë të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje të bindin Bankën që Përfituesi ka të drejtën e shumës së Livrimit dhe që shuma e Livrimit do të përdoret ekskluzivisht për Zërat e Financuar nga Granti. Këto dokumente përfshijnë, por pa u kufizuar në faturat e Kontraktorit, të vërtetuara nga ose në



emër të Përfituesit, në faturën faktike ose në formën e një vërtetimi të veçantë, që tregon konfirmimin e Përfituesit që mallrat, punët ose shërbimet janë dhënë rregullisht ose kryer në pajtim me kërkesat e kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratës përkatëse.

e) Monedha e Livrimeve

Livrimet bëhen në euro në një shumë të barasvlershme me shpenzimet që do të financohen nga shumat e Grantit. Në rastin e shpenzimeve të bëra në monedhën ose monedhat e ndryshme nga euro, shuma përkatëse e Disbursimit përcaktohet si më poshtë:

1. Nëse Përfituesi e kërkon pagesën në euro, Banka përcakton shumën e barasvlershme të Livrimit pas pagesës.

2. Nëse Përfituesi kërkon pagesën në monedhën ose monedhat e shpenzimeve, Banka, me kusht që këto shpenzimeve të jenë në monedhën ose monedhat e disponueshme, e blen këtë monedhë ose monedha në një mënyrë të tillë që Banka mund ta konsiderojë të përshtatshme. Shuma e barasvlershme e Livrimit përcaktohet nga Banka mbi bazën e shpenzimeve të shkëmbimit që janë pësuar ose do të pësoheshin nga Banka duke përdorur euro për të përmbushur kërkesën.

f) Pagesat në monedha të tjera

Në rrethana të veçanta, Banka mund të përmbushë një kërkesë të Përfituesit që pagesa të bëhet në një monedhë ose monedha të ndryshme nga euro ose në monedhën e shpenzimeve. Në këtë rast, Banka do ta blejë këtë monedhë ose monedha në atë mënyrë që Banka e konsideron të përshtatshme. Shuma e barasvlershme e Livrimit përcaktohet nga Banka mbi bazën e shpenzimeve të shkëmbimit që janë pësuar ose do të pësoheshin nga Banka duke përdorur euro për të përmbushur kërkesën.

g) Shuma minimale e Livrimit

Përveç Livrimit të fundit ose kur Banka bie dakord ndryshe, Livrimet bëhen në shumat prej jo më pak së 250.000 euro.

h) Parapagimi

Pa kufizuar përgjithësimin e Seksionit 2.02 (Livrimet) të kësaj Marrëveshjeje, dhe përveç kur bihet dakord ndryshe nga Banka, çdo Livrim i kërkuar nga Përfituesi për një parapagim shoqërohet nga një garanci, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, të lëshuar në interes të Bankës nga një bankë ose institucion financiar i njohur, në shumat dhe monedhat e barabarta me shumën e Livrimit.

Seksioni 2.03

Detyrimet e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara për rimbursim

a) Me kërkesë të Përfituesit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, Banka, në pajtim me dispozitat e zbatueshme të Manualit të Livrimit të BERZH-it, *mutatis mutandis*, mund të caktojë detyrime të kushtëzuara ose të pakushtëzuara për Rimbursimin për të rimbursuar pagesat e bëra nga bankat sipas letrave të kredisë në lidhje me shpenzimet që duhet të financohen nga Granti. Çdo rimbursim i tillë përbën një Livrim.

b) Në rastin e një Detyrimi të kushtëzuar për rimbursimin, detyrimi i Bankës për të paguar pezullohet ose pushon menjëherë pas një pezullimi ose anulimi të Grantit nga Banka në pajtim me Seksionin 5.01 (Pezullimi) ose Seksionin 5.02 (Anulimi) të kësaj Marrëveshjeje.

c) Në rastin e një detyrimi të pakushtëzuar të Rimbursimit, Detyrimi i Bankës për të bërë një pagesë nuk ndikohet nga një pezullim ose anulim pasues i Grantit.

Seksioni 2.04
Anulimi nga Përfituesi

Përfituesi mund të anulojë në çdo kohë, në jo më pak së tridhjetë (30) ditë punë para njoftimit me shkrim drejtuar Bankës, plotësisht ose pjesërisht, çdo pjesë të palivruar të Grantit. Çdo njoftim i tillë anulimi nga Përfituesi është i përvokueshëm dhe detyrues për Përfituesin.

Seksioni 2.05
Pagesat

a) Përveç kur bihet dakord ndryshe me shkrim nga Banka, shumat që duhet të livrohen nga Banka sipas kësaj Marrëveshjeje paguhet drejtpërdrejt në llogarinë e Kontraktorit përkatës që e përcakton Përfituesi në kërkesën e tij për Livrim.

b) Nëse data e kërkueshme për një pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje do të binte përndryshe në një ditë që nuk është ditë punë, kjo pagesë bëhet e kërkueshme në ditën pasuese të punës.

c) Çdo shumë që mund të bëhet e kërkueshme nga Banka sipas kësaj Marrëveshjeje paguhet pa kompensim ose kundërpretendim në euro për vlerën në datën e kërkueshme, në atë llogari në Londër, Angli ose një vend tjetër që Banka mund të caktojë herë pas here me një njoftim drejtuar Përfituesit.

Seksioni 2.06
Rialokimi

a) Nëse Banka vlerëson që shuma e Grantit e alokuar në një Zë të Financuar nga Granti do të jetë e mjaftueshme për të financuar përqindjen e rënë dakord të shpenzimeve për atë Zë të Financuar të Grantit, Banka, nëpërmjet njoftimit drejtuar Përfituesit:

i) mund të rialokojë në këtë Zë të Financuar nga Granti në masën e kërkuar për të përmbushur diferencën e vlerësuar, shuma të Grantit që para këtij rialokimi kanë qenë alokuar të një Zë tjetër i Financuar i Grantit dhe që sipas mendimit të Bankës, nuk nevojiten për të përmbushur shpenzime të tjera; dhe

ii) nëse ky rialokim nuk mund të përmbushë diferencën e parashikuar, mund të ulë përqindjen e shpenzimeve që do të financohen me qëllim që Livrimet e tjera sipas këtij Zëri të Financuar nga Granti të mund të vazhdojnë derisa të bëhen të gjitha shpenzimet sipas saj.

b) Në rast së një rialokim ndodh në pajtim me paragrafin (a)(i) të mësipërm, Përfituesi mund t'i kërkojë Bankës të bëjë një rialokim tjetër të një shume të barasvlershme të shumave të Grantit të një Zë tjetër i Financuar i Grantit që është rënë dakord bashkërisht nga Përfituesi dhe Banka. Banka jep rialokimin e kërkuar me njoftim ndaj Marrësit. Një rialokim i tillë bëhet efektiv kur jepet njoftimi.

Neni 3
Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 3.01
Bashkëpunimi dhe informimi

a) Dispozitat e Seksionit 4.01 (bashkëpunimi dhe informimi) i Termave dhe Kushteve Standarde zbatohen sikur të ishin parashikuar këtu plotësisht *mutatis mutandis*, duke përfshirë pa cenuar përgjithësimin e tij, sikur:

i) referencat të "Huamarrësi" të lexoheshin si referenca të "Përfituesi";



- ii) referencat të “Huaja” të lexoheshin si referenca të “Granti”; dhe
 - iii) referencat të “Marrëveshja e Huas” të lexoheshin si referenca të “kjo Marrëveshje”.
- b) Në marrjen e informacionit në lidhje me Marrëveshjen e Huas, Banka mund të përdorë dhe të mbështetet mbi çdo informacion të tillë në cilësinë e saj si dhënëse e Grantit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02

Përgjegjësitë në lidhje me ekzekutimin e Projektit

- a) Përfituesi, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe:
1. zbaton Projektin me kujdesin dhe eficiencën e duhur dhe në pajtim me Marrëveshjen e Huas;
 2. zbaton Projektin në pajtim me Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social dhe Kërkesat e Caktuara të Përmbushjes, në pajtim me çdo modifikim që Banka mund të bjerë dakord me shkrim;
 3. krijon dhe operon gjatë gjithë kohës së zbatimit të Projektit një Grup Drejtues Projekti, që përbëhet nga përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë dhe të Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe që kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, që është përgjegjës për monitorimin e përgjithshëm të Projektit dhe mbledhet të paktën çdo gjashtë muaj;
 4. merr masa që Fondi Shqiptar i Zhvillimit të caktojë personel të kualifikuar për të mbështetur Grupin e Drejtimit të Projektit duke përgatitur agjendën dhe protokollin e mbledhjeve;
 5. merr të gjitha masat e nevojshme për të gjitha Marrëveshjet e Operacioneve dhe Mirëmbajtjes që duhet të nënshkruhen para tenderit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe njësisive të pushtetit lokal, të cilat përfshijnë: i) parimet e përgjithshme për prokurimin dhe menaxhimin e kontratave shumëvjeçare të mirëmbajtjes; ii) konfirmimin që kostoja e kontratës shumëvjeçare të mirëmbajtjes të përfshihet në buxhetin e njësisive të pushtetit lokal për të pesta vitet e ardhshme; iii) një projektkontratë shumëvjeçare për mirëmbajtjen rutinë për një periudhë pesëvjeçare, me një standard në pajtim me kategorizimin funksional të rrugës;
 6. merr masa që Fondi Shqiptar i Zhvillimit të ofrojë trajnim për nëpunësit brenda njësisive të pushtetit lokal, të cilët do të punojnë për mirëmbajtjen; dhe
 7. merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përfundimin me sukses të Projektit deri më 31 dhjetor 2015 ose në një datë të mëvonshme që mund të bihet dakord me shkrim ndërmjet Palëve.
- b) Dispozitat e Seksionit 4.02(b), 4.02(d) dhe 4.02(f) (Përgjegjësitë në lidhje me Ekzekutimin e Projektit) i Termave dhe Kushteve Standarde zbatohen sikur të të ishin parashikuar këtu plotësisht *mutatis mutandis*, duke përfshirë pa cenuar përgjithësimin e tij, sikur:
- i) referencat të “Huamarrësi” të lexoheshin si referenca të “Përfituesi”; dhe
 - ii) referencat të “shumat e Huas” të lexoheshin si referenca të “Granti”.

Seksioni 3.03

Përputhshmëria mjedisore dhe sociale

Përveç kur Banka bie dakord ndryshe, Përfituesi siguron që pjesa e Projektit e financuar nga Granti të kryhet në pajtim me Seksionin 3.03 (Detyrimet e përputhshmërisë mjedisore dhe sociale) të Marrëveshjes së Huas.

Seksioni 3.04

Prokurimi

a) Përveç kur Banka bie dakord ndryshe, prokurimi i Zërave të Financuar nga Granti rregullohet nga Rregullat e Prokurimit të BERZH-it.

b) Zërat e financuar nga Granti prokurohen me tender të hapur dhe në raste të veçanta me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës, nëpërmjet tenderit konkurrues lokal.

c) Për qëllimet e Seksionit 3.04 (a) dhe (b), procedurat për tender të hapur dhe standardet për procedurat e tenderimit lokal të hapur janë parashikuar në Kapitullin 3 të Rregullave të Prokurimit të BERZH-it.

d) Të gjitha kontratat u nënshtrohen procedurave të rishikimit pasues të Bankës sipas parashikimit në Rregullat e Prokurimit të BERZH-it.

Seksioni 3.05

Regjistrat dhe raportet e Projektit; ekzaminimet

a) Përfituesi garanton që informacioni i dhënë Bankës nga FSHZH-ja në emër të Përfituesit dhe regjistrat e mbajtur nga FSHZH-ja në emër të Përfituesit, në pajtim me detyrimet e Përfituesit, në cilësinë e tij si Huamarrës, në pajtim me Seksionin 3.05 (Shpeshhtësia e Raportimit dhe Kërkesat e Paraqitjeve) të Marrëveshjes së Huas, si dhe Seksionin 4.04 (Regjistrat dhe raportet e Projektit) dhe Seksionin 5.02 (Raportimi) të Termave dhe Kushteve Standarde:

1. përfshijnë informacion të hollësishëm në lidhje me Kontratat, Kontraktorët, Livrimet, Grantin dhe përdorimin e tij, Zërat e Financuar nga Granti, si dhe statusin e përputhshmërisë me çdo detyrim që parashikohet në këtë Marrëveshje në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;

2. përmban informacion të plotë për të mundësuar konstatimin e Grantit të dalluar nga Financimi i Huas;

3. përmban informacion të plotë për të mundësuar konstatimin e Grantit IPA 2010 të dalluar nga Granti IPA 2011; dhe

4. përfshin çdo informacion tjetër në lidhje, ndërmjet të tjerash, me Përfituesin, Projektin dhe transaksionet e parashikuara në Marrëveshje që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme herë pas here.

b) Menjëherë sapo të jetë e mundur, por në çdo rast brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të Kontratës së fundit, Përfituesi i paraqet ose merr masa që Fondi Shqiptar i Zhvillimit t'i paraqesë Bankës (nëse kërkohet nga Banka, të certifikuar nga një nëpunës i autorizuar i Përfituesit) një raport përfundimtar në lidhje me përdorimin e Grantit IPA 2010 dhe të Grantit IPA 2011, që specifikon me hollësi të gjitha Kontratat, të gjithë Kontraktorët, Zërat e Financuar nga Granti dhe grafikët e dorëzimit dhe ngritjes dhe krahasimin me parashikimet fillestare.

c) Menjëherë sapo të jetë e mundur, por në çdo rast brenda tridhjetë (30) ditëve pas Datës së Përfundimit të Projektit, Përfituesi i paraqet ose merr masa që Fondi Shqiptar i Zhvillimit t'i paraqesë Bankës (nëse kërkohet nga Banka, të certifikuar nga një nëpunës i autorizuar i Përfituesit) një raport përfundimtar në lidhje me Projektin, duke identifikuar përdorimin e Grantit.

d) Përfituesi u mundëson përfaqësuesve të Bankës dhe të Donatorit, me kërkesë të Bankës:

1. të vizitojnë çdo strukturë dhe kantier ndërtimi në lidhje me Projektin;

2. të ekzaminojnë të gjitha mallrat, punët dhe shërbimet e financuara nga shumat e Grantit dhe çdo fabrikë, instalim, kantier, punë, ndërtesë, pronë, pajisje, regjistër dhe dokument në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të Përfituesit sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

3. për këto qëllime, të mblidhet dhe të diskutojë me përfaqësuesit dhe punonjësit e Përfituesit nëse Banka e konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme.

e) Pas dhënies së një Kontrate, Banka mund të publikojë një përshkrim të tij, emrin dhe shtetësinë e Kontraktorit dhe çmimin e kontratës.

f) Përfituesi merr masa që Fondi Shqiptar i Zhvillimit t'i mundësojë Bankës, Donatorëve dhe përfaqësuesve të tyre përkatës akses në regjistrat e Përfituesit në lidhje me projektin dhe Grantin.



Seksioni 3.06 **Pashmëria**

a) Përfituesi merr të gjitha masat e nevojshme për të publikuar në publikimet, komunikimet përkatëse, si dhe në media faktin që Projekti ka marrë fonde, ndërmjet të tjerash, nga Bashkimi Evropian.

b) Përfituesi përfshin në të gjitha materialet e tij promovuese në lidhje me Projektin, një referencë të faktit që Projekti është i mbështetur me financimin e Bashkimit Evropian në pajtim me Udhëzimet e fundit të BE-së për Pashmërinë që gjenden në faqen e internetit:

http://europa.eu.int/comm/europeaid/visibility/index_en.htm

Neni 4 **Detyrime financiare dhe operacionale**

Seksioni 4.01 **Regjistra dhe raporte financiare**

a) Përfituesi siguron që Fondi Shqiptar i Zhvillimit të mbajë në emër të Përfituesit regjistra dhe llogari të veçanta në lidhje me Grantin, në pajtim me standardet e kontabilitetit të pranuar ndërkombëtarisht të zbatuara në mënyrë të njësuar.

b) Përfituesi garanton që informacioni i dhënë Bankës, dhe regjistrat e mbajtur nga Përfituesi, në pajtim me detyrimet e Përfituesit, në cilësinë e tij si Huamarrës, në pajtim me Seksionin 4.01(b) (Regjistrat dhe Raportet Financiare) të Marrëveshjes së Huas, si dhe Seksionin 5.02(c)(i) (Raportimi) të Termave dhe Kushteve Standarde:

1. përfshin informacion të hollësishëm në lidhje me Grantin dhe përdorimin e tij, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;

2. përmban informacion të plotë për të mundësuar konstatimin e Grantit të dalluar nga Financimi i Huas;

3. përmban informacion të plotë për të mundësuar konstatimin e Grantit IPA 2010 të dalluar nga Granti IPA 2011; dhe

4. përfshin çdo informacion tjetër në lidhje me këta regjistra, llogari dhe pasqyra financiare që Banka mund të kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

Seksioni 4.02 **Kryerja e biznesit dhe operacioneve**

Përfituesi, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe:

a) përmbush rregullisht të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje në cilësinë e tij si Huamarrësi, sipas Marrëveshjes së Huas; dhe

b) nënshkruan çdo dokument tjetër dhe ndërmerr çdo veprim tjetër që Banka e cakton të nevojshëm ose të dëshirueshëm për t'i dhënë fuqi Marrëveshjes.

Seksioni 4.03 **Tatimet**

a) Përfituesi, nëse bëhen të kërkueshme, paguan të gjitha Tatimet e caktuara atij dhe që paguhen për ose në lidhje me nënshkrimin, lëshimin, dhënien, regjistrimin ose noterizimin e kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë dhënien e Grantit) ose çdo dokument tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje.

b) Asnjë pjesë e shumave të Grantit nuk përdoren, drejtpërdrejt ose jo, për pagesën e Tatimeve, qofshin të drejtpërdrejta ose jo, në territorin e Republikës së Shqipërisë apo gjetkë.

Seksioni 4.04

Mashtrimi dhe korrupsioni

Marrësi nuk do të angazhojë dhe as do të lejojë apo autorizojë ndonjë nga zyrtarët e tij, drejtorë, punonjës të autorizuar, agjentë apo përfaqësues, që të angazhojnë asnjë Praktikë të Ndaluar sipas, ose në lidhje me, Projektin, Grantin apo ndonjë transaksion në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni 5

Pezullimi dhe anulimi; shlyerja

Seksioni 5.01

Pezullimi

a) Nëse një prej ngjarjeve të mëposhtme ka ndodhur dhe vazhdon, Banka, duke njoftuar Përfituesin, e pezullon pjesërisht ose plotësisht të drejtën e Përfituesit për Livrime të tjera sipas kësaj Marrëveshjeje:

1. Marrëveshja e Huas pushon së qeni në fuqi të plotë ose prishet.
2. Përfituesi nuk ka përmbushur ose nuk përmbush një prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose një prej detyrimeve të tij në cilësinë e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas.
3. Banka ka pezulluar ose ka ndodhur një ngjarje që i jep Bankës të drejtën për të pezulluar, plotësisht ose pjesërisht, të drejtën e Përfituesit në cilësinë e tij si Huamarrës të bëjë kërkesa për tërheqje, në pajtim me Seksionin 7.01 (Pezullimi) i Termave dhe Kushteve Standarde ose Seksionin 5.01 (Pezullimi) i Marrëveshjes së Huas.
4. Banka ka anuluar ose ka ndodhur një ngjarje që i jep Bankës të drejtën për të anuluar, plotësisht ose pjesërisht, Financimin e Huas në pajtim me Seksionin 7.02 (Anulimi) i Termave dhe Kushteve Standarde ose Seksionin 5.03 (Anulimi) i Marrëveshjes së Huas.
5. Ka ndodhur dhe po vazhdon një Ngjarje Përshpejtimi sipas Marrëveshjes së Huas dhe/ose Termave dhe Kushteve Standarde dhe Banka ka deklaruar që e gjitha ose një pjesë e Financimit të Huas është i kërkueshëm dhe i pagueshëm në pajtim me Seksionin 7.06 (Ngjarjet e Përshpejtitimit) të Termave dhe Kushteve Standarde;
6. Ka ndodhur një ngjarje e jashtëzakonshme si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur, të cilat e bëjnë të pamundur që projekti të realizohet ose Përfituesi nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.
7. Marrëveshja IPA 2010 dhe/ose Marrëveshja IPA 2011 është prishur ose është bërë njoftimi për prishjen e saj.
8. Një përfaqësim i bërë nga Përfituesi në lidhje me këtë Marrëveshje ka qenë i pasaktë ose i gabuar në një aspekt material.
9. Përfituesi në cilësinë e tij si Huamarrës ka anuluar plotësisht ose pjesërisht një pjesë të palivruar të Financimit të Huas në pajtim me Seksionin 3.08 (Anulimi) të Termave dhe Kushteve Standarde.
10. Përfituesi ose një prej nëpunësve, punonjësve, agjentëve ose përfaqësuesve të tij është konstatuar nga një proces gjyqësor ose hetim tjetër zyrtar të jetë përfshirë në një Praktikë të Ndaluar.
11. Statutet e Marrësit dhe/ose FSHZH-së të jenë ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar, anuluar apo hequr dorë në një mënyrë të tillë sa prek në mënyrë thelbësore dhe të pafavorshme operacionet ose kushtet financiare të Marrësit dhe/ose FSHZH-së ose aftësinë e Marrësit për të realizuar Projektin apo për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje.



b) E drejta e Përfituesit për Livrime të tjera vazhdon të jetë e pezulluar plotësisht ose pjesërisht, sipas rastit, derisa ngjarja ose ngjarjet që kanë shkaktuar pezullimin të kenë pushuar së ekzistuari, përveç kur Banka të ketë njoftuar Përfituesin që e drejta e tij për Livrime të tjera është rivendosur; megjithatë, me kusht që e drejta për Livrime të tjera rivendoset vetëm në masën dhe në pajtim me kushtet e specifikuara në një njoftim të tillë, dhe asnjë njoftim i tillë nuk ndikon ose cenon ndonjë të drejtë, tagër apo mjet mbrojtës të Bankës në lidhje me një ngjarje tjetër ose pasuese të përshkruar në këtë Seksion.

Seksioni 5.02

Anulimi nga Banka

a) Nëse në një moment të caktuar, Banka pas konsultimeve me Përfituesin, vendos që një shumë e Grantit nuk do të nevojitet për të financuar koston e projektit që duhet të financohet nga Granti, Banka, duke njoftuar Përfituesin, e anulon këtë shumë të Grantit. Në datën e fundit të disponibilitetit të Grantit, çdo pjesë e palivruar e Grantit anulohet automatikisht, përveç kur bihet dakord ndryshe me shkrim nga Banka.

b) Nëse e drejta e Përfituesit për Disbursimet e një pjese të Grantit sipas kësaj Marrëveshjeje është pezulluar në pajtim me Seksionin 5.01 (Pezullimi) të kësaj Marrëveshjeje për një periudhë në vazhdim prej tridhjetë (30) ditësh, Banka, duke njoftuar Përfituesin, e anulon Grantin, plotësisht ose pjesërisht.

c) Nëse Banka ka anuluar ose ka ndodhur një ngjarje që i jep Bankës të drejtën për të anuluar, plotësisht ose pjesërisht, Financimin e Huas në pajtim me Seksionin 7.02 (Anulimi) i Termave dhe Kushteve Standarde, Banka, duke njoftuar Përfituesin, e anulon Financimin e Grantit plotësisht ose pjesërisht.

d) Nëse në një moment të caktuar, Banka përcakton se:

1. prokurimi i një prej Zërave të Financuar nga Granti nuk është në pajtim me këtë Marrëveshje;

2. fondet e livruara sipas kësaj Marrëveshjeje janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

3. në lidhje me një Kontratë, një përfaqësues i Përfituesit ose një Kontraktori është përfshirë në një Praktikë të Ndalar gjatë prokurimit ose nënshkrimit të kësaj kontrate, dhe Përfituesi nuk ka marrë masa në kohë dhe të përshtatshme që të jenë të pranueshme për Bankën për të korrigjuar situatën.

Banka, nëpërmjet njoftimit drejtuar Përfituesit, mund të pezullojë Grantin plotësisht ose pjesërisht. Ky anulim hyn në fuqi në momentin e marrjes së njoftimit.

e) Nëse në një moment të caktuar Banka përcakton që një përfaqësues i Përfituesit është konstatuar nga një proces gjyqësor ose një hetim zyrtar të jetë përfshirë në një praktikë të ndalar, Banka, nëpërmjet njoftimit drejtuar Përfituesit, anulon plotësisht ose pjesërisht Grantin. Ky anulim hyn në fuqi në momentin e marrjes së njoftimit.

Seksioni 5.03

Detyrime të pakushtëzuara të rimbursimit të pacenuara nga pezullimi ose anulimi

Asnjë anulim apo pezullim nuk zbatohet për shumat që i nënshtrohen një Detyrimi të pakushtëzuar të Rimbursimit të marrë përsipër nga Banka në pajtim me Seksionin 2.03 (Detyrimet e Kushtëzuara dhe të Pakushtëzuara të Rimbursimit) të kësaj Marrëveshjeje, përveç kur janë parashikuar shprehimisht në një detyrim të tillë.

Seksioni 5.04
Detyrimet e Përfituesit

Pavarësisht anulimit apo pezullimit, të gjitha dispozitat e Marrëveshjes mbeten në fuqi të plotë, përveç kur kjo parashikohet specifikisht.

Seksioni 5.05
Ngjarje të shlyerjes

Nëse një prej ngjarjeve të mëposhtme ka ndodhur dhe vazhdon për një periudhë të specifikuar më poshtë, në çdo kohë gjatë vazhdimit të kësaj ngjarjeje, Banka, nëpërmjet njoftimit drejtuar Përfituesit, mund të kërkojë që Përfituesi të shlyejë të gjithë ose një pjesë të Grantit (dhe të paguajë çdo shumë tjetër të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje) dhe kjo bëhet (pavarësisht parashikimeve të kundërta në këtë Marrëveshje) menjëherë e kërkueshme dhe e pagueshme:

a) Ka ndodhur një ngjarje e specifikuar në Seksionin 5.01(a)(1) (Pezullimi) të kësaj Marrëveshjeje.

b) Ka ndodhur një ngjarje e specifikuar në Seksionin 5.01(a)(2) (Pezullimi) të kësaj Marrëveshjeje dhe, nëse është e mundshme të korrigojë, ka vazhduar për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh pasi të jetë bërë njoftimi nga Banka.

c) Ka ndodhur dhe po vazhdon një ngjarje përshpejtimi sipas Marrëveshjes së Huas ose Termave dhe Kushteve Standarde dhe Banka ka deklaruar që e gjitha ose një pjesë e Financimit të Huas është i kërkueshëm dhe i pagueshëm në pajtim me Seksionin 7.06 (ngjarjet e përshpejtitimit) të Termave dhe Kushteve Standarde.

d) Banka konstaton në një moment të caktuar që një prej përfaqësuesve të Përfituesit është konstatuar nga një proces gjyqësor ose hetim tjetër zyrtar të jetë përfshirë në një Praktikë të Ndaluar.

e) Përfituesi në cilësinë e tij si Huamarrës ka anuluar plotësisht ose Pjesërisht një pjesë të palivruar të Financimit të Huas në pajtim me Seksionin 3.08 (Anulimi) të termave dhe Kushteve Standarde.

Neni 6
Ekzekutueshmëria, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Seksioni 6.01
Ekzekutueshmëria

Të drejtat dhe detyrimet e Përfituesit janë të vlefshme dhe të ekzekutueshme në pajtim me termat e tyre, pavarësisht ligjeve lokale që parashikojnë të kundërtën. Përfituesi nuk ka të drejtë në asnjë rrethanë të ngrejë ndonjë pretendim që një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme ose e paekzekutueshme për një arsye të caktuar.

Seksioni 6.02
Mosushtrimi i të drejtave

Asnjë vonesë në ushtrimin ose mosushtrimin e një të drejte, tagri apo mjeti që i takon një pale sipas kësaj Marrëveshjeje në rastin e një qenieje në vonesë nuk e cenon këtë të drejtë, tagër apo mjet dhe nuk interpretohet sikur hiqet dorë prej saj apo sikur kjo tolerohet; asnjë veprim i kësaj pale në lidhje me këtë qenie në vonesë apo tolerim të saj nuk cenon apo dëmton ndonjë të drejtë, tagër apo mjet të kësaj pale në lidhje me një qenie tjetër në vonesë.



Seksioni 6.03

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Dispozitat e Seksionit 8.04 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) të Termave dhe Kushteve Standarde zbatohen sikur të të ishin parashikuar këtu plotësisht *mutatis mutandis*, duke përfshirë, pa cenuar përgjithësimin e tij, sikur:

- i) referencat të “Marrëveshja e Huas”, “Marrëveshje e Garancisë” ose “Marrëveshja e Projektit” të lexoheshin si referenca të “Kjo Marrëveshje”; dhe
- ii) referencat të “Huamarrësi” ose të “një Subjekt i Projektit” të lexoheshin si referenca të “Përfituesi”.

Neni 7

Hyrja në fuqi; zgjidhja

Seksioni 7.01

Data e hyrjes në fuqi

Përveç kur Banka dhe Përfituesi bien dakord ndryshe, kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën në të cilën Banka i dërgon Përfituesit njoftim për pranimin nga ana e Bankës të provave të kërkuara sipas Seksionit 7.02 (Kushtet paraprake për hyrjen në fuqi) dhe Seksionit 7.03 (Mendimet ligjore) të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.02

Kushtet paraprake të hyrjes në fuqi

Kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi përveç kur Banka është e bindur që kushtet e mëposhtme paraprake janë përmbushur, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën ose në diskrecionin e vetëm të Bankës, kur është hequr dorë prej tyre, plotësisht ose pjesërisht, me kusht ose pa kusht:

- a) Banka ka marrë një kopje origjinale të nënshkruar rregullisht të kësaj Marrëveshjeje;
- b) të gjitha kushtet paraprake në lidhje me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Huas sipas Seksionit 9.02 (Kushtet Paraprake të Qenies Në fuqi) të Termave dhe Kushteve Standarde Dhe seksionit 6.01 (Kushtet Paraprake të Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe Disbursimin e Transhit B) të Marrëveshjes së Huas, përveç së hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje duhet të jetë përmbushur, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;
- c) Banka ka marrë prova që Grupi Drejtues i Projektit është krijuar dhe ka personel të përshtatshëm;
- d) Bankës i janë dhënë të dhëna, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, që nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit është autorizuar, aprovuar ose ratifikuar nëpërmjet të gjitha masave të nevojshme qeveritare, administrative ose korporative; dhe
- e) Bankës i është dhënë çdo dokument tjetër që mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

Seksioni 7.03

Mendimet ligjore

Si pjesë e provave që duhet të jepen në pajtim me Seksionin 7.02 (Kushtet paraprake për hyrjen në fuqi) të kësaj Marrëveshjeje, Përfituesi i paraqet ose merr masa për paraqitjen Bankës të një mendimi në emër të Përfituesit nga Ministri i Drejtësisë, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, në lidhje me këtë Marrëveshje, dhe që tregon së kjo Marrëveshje është autorizuar,

aprovuar ose ratifikuar rregullisht dhe nënshkruar dhe dhënë në emër të Përfituesit dhe që përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues të Përfituesit, të ekzekutueshëm në pajtim me termat e saj.

Seksioni 7.04

Prishja për shkak të moshyrjes në fuqi

a) Nëse kjo Marrëveshje nuk ka hyrë në fuqi deri në datën që është nëntëdhjetë (90) ditë kalendarike nga data e kësaj Marrëveshjeje; ose

b) Nëse Marrëveshja e Huas nuk ka hyrë në fuqi në datën e specifikuar në Seksionin 6.03 (Prishja për shkak të moshyrjes në fuqi) të Marrëveshjes së Huas ose një datë e mëvonshme e njoftuar nga Banka, Përfituesit në cilësinë e tij si Huamarrës në pajtim me Seksionin 9.04 të Termave dhe Kushteve Standarde;

të gjitha detyrimet e Bankës sipas kësaj Marrëveshjeje pushojnë, përveç kur Banka, pas shqyrtimit të shkaqeve të vonesës, vendos një datë të mëvonshme për qëllimet e këtij Seksioni. Banka njofton menjëherë Përfituesin për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 7.05

Pushimi i fuqisë pas përmbushjes

a) Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi deri sa Përfituesi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet e veta përkatëse në pajtim me këto dispozita, përveç kur zgjidhet më parë në pajtim me termat e saj; me kusht që dispozitat e Seksionit 6.03 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) mbetet në fuqi pas prishjes së Marrëveshjes.

b) Pavarësisht dispozitave me efekt të kundërt në këtë Marrëveshje, dispozitat e Seksionit 5.05(d) (Ngjarjet e shlyerjes) mbeten në fuqi pas prishjes së kësaj Marrëveshjeje për pesë (5) vjet pas datës së përfundimit të Projektit.

Neni 8

Të ndryshme

Seksioni 8.01

Njoftimet

Çdo njoftim ose kërkesë që kërkohet ose lejohet të bëhet në pajtim me këtë Marrëveshje bëhet me shkrim. Përveç kur parashikohet ndryshe në Seksionin 7.01 (Data e hyrjes në fuqi) të kësaj Marrëveshjeje, ky njoftim ose kërkesë konsiderohet të jetë bërë rregullisht nëse i është dorëzuar palës që duhet t'i dorëzohet në adresën e palës të specifikuar më poshtë ose në një adresë tjetër që kjo palë i ka specifikuar me shkrim palës tjetër që bën njoftimin ose kërkesën. Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje ose Manualin e Livrimit të BERZH-it, ky dorëzim bëhet dorazi, me postë ose faks. Dorëzimet e bëra me faks konfirmohen edhe me postë.

Për Përfituesin:

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1

Tiranë/Shqipëri

Në vëmendje të: Ministër i Financave

Fax: +355 4 222 8494



Për Bankën:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

One Exchange Square

London EC2A 2JN

United Kingdom

Në vëmendje të: Departamentit të Administrimit të Operacioneve

Fax: +44 20 7338 6100

Seksioni 8.02

Autoriteti për të vepruar

Çdo veprim i kërkuar ose që lejohet të ndërmerret dhe çdo dokument që kërkohet ose lejohet të nënshkruhet sipas kësaj Marrëveshjeje nga Përfituesi ndërmerret ose nënshkruhet nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit ose një nëpunës tjetër i Përfituesit që Përfaqësuesi i Autorizuar e cakton me shkrim. Përfituesi i paraqet Bankës prova të autoritetit dhe ekzemplarin e nënshkrimit të autorizuar të çdo nëpunësi të tillë thelbësisht në formën e Shtojcës 2 (Forma e Letrës që Cakton Nënshkruesit e Autorizuar).

Seksioni 8.03

Ndryshimet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me një instrument shkresor të nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit dhe nga një nëpunës i autorizuar rregullisht i Bankës.

Seksioni 8.04

Gjuha angleze

Kjo Marrëveshje është përgatitur dhe nënshkruar në gjuhën angleze. Çdo dokument i dhënë në pajtim me këtë Marrëveshje është në gjuhën angleze. Dokumentet në një gjuhë tjetër shoqërohen me një përkthim në anglisht të vërtetuar sikur të jetë përkthim i aprovuar dhe ky përkthim është përfundimtar.

Seksioni 8.05

Zhdëmtimi

a) Përfituesi merr përgjegjësi të plotë dhe bie dakord dhe zhdëmton dhe e mban të padëmtuar Bankën dhe nëpunësit, drejtorët, punonjësit, agjentët dhe ofruesit e shërbimeve ndaj çdo detyrimi, humbjeje, dëmi (kompensues, dënues ose tjetër), gjobe, pretendimi, veprimi, tatimi, padie, kostoje dhe shpenzimi (duke përfshirë tarifën dhe shpenzimet e arsyeshme ligjore dhe koston e hetimit) të çdo natyre dhe lloji, duke përfshirë, pa cenuar përgjithësimin e sa më sipër, ato që rrjedhin nga kontratat ose veprimet dëmtuese (duke përfshirë neglizhencën) ose nga përgjegjësia e drejtpërdrejtë apo tjetër, që i vendosen ose shkaktohen apo ngrihen ndaj Bankës ose nëpunësve, drejtorëve, punonjësve, agjentëve ose dhënësve të shërbimeve (pavarësisht nëse janë zhdëmtuar nga një person tjetër sipas një dokumenti tjetër) dhe që në një mënyrë të caktuar kanë të bëjnë ose rrjedhin drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt:

1. nga një veprim i parashikuar në këtë Marrëveshje ose nga nënshkrimi, dorëzimi apo përmbushja e saj;

2. nga operimi ose mirëmbajtja e mjediseve të Përfituesit ose pronësia, kontrolli apo posedimi i tyre nga Përfituesi; ose

3. ushtrimi nga Banka i një prej të drejtave ose mjeteve mbrojtëse sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

me kusht që Banka nuk ka ndonjë të drejtë të zhdëmtohet për shkak të neglizhencës së saj të hapur apo veprimit të qëllimshëm.

b) Përfituesi njih që Banka po lidh këtë Marrëveshje dhe ka vepruar vetëm si dhënës i Grantit, dhe jo si një këshilltar për Përfituesin. Përfituesi përfaqëson dhe garanton që me lidhjen e kësaj Marrëveshjeje, ai është përfshirë dhe mbështetet në këshillën e dhënë atij nga këshilltarët e vet ligjorë, financiarë dhe të tjerë profesionalë dhe nuk është mbështetur dhe nuk do të mbështetet pas kësaj në ndonjë këshillë të dhënë nga Banka.

Seksioni 8.06 **Transferimet**

Përfituesi nuk mund të kalojë ose transferojë të gjithë ose një pjesë të të drejtave dhe detyrimeve përkatëse të tij sipas kësaj Marrëveshjeje pa pëlqimin e mëparshëm me shkrim të Bankës.

Seksioni 8.07 **Të drejtat, mjetet mbrojtëse dhe heqja dorë**

Të drejtat dhe mjetet mbrojtëse të Bankës sipas kësaj Marrëveshjeje nuk cenohen nga asnjë veprim apo send që, përveç këtij Seksioni, mund të cenojnë këto të drejta ose mjete mbrojtëse. Asnjë mënyrë veprimi dhe asnjë vonesë në ushtrimin apo mosushtrimin e një të drejte, kompetence apo mjeti mbrojtës nga Banka nuk cenon këtë të drejtë, kompetencë apo mjet mbrojtës dhe as interpretohet sikur hiqet dorë prej saj. Çdo heqje dorë nga një term apo kusht i kësaj Marrëveshjeje bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga Banka. Në rast së Banka heq dorë nga një kusht për një Livrim të Grantit, Përfituesi, duke marrë këtë Livrim, konsiderohet të ketë rënë dakord me termat e kësaj heqjeje dorë dhe me të drejtën e Bankës për të kërkuar që respektimi i këtij kushti të ruhet shprehimisht për qëllimet e një Livrimi të mëvonshëm. Të drejtat dhe mjetet mbrojtëse të parashikuara në këtë Marrëveshje dhe marrëveshjet e tjera të parashikuara këtu janë kumulative dhe nuk përjashtojnë një ushtrim tjetër apo të mëtejshëm ose ushtrimin e një të drejte apo mjeti mbrojtës tjetër.

Seksioni 8.08 **Deklarimi**

Banka mund të deklarojë këto dokumente, informacione dhe regjistra në lidhje me Përfituesin dhe ky transaksion (duke përfshirë kopje të kësaj Marrëveshjeje dhe të një marrëveshjeje tjetër të parashikuar këtu, që Banka e konsideron të përshtatshme për çdo qëllim në lidhje me një mosmarrëveshje që përfshin Përfituesin, për qëllimin e ruajtjes ose ekzekutimit e të drejtave të Bankës sipas kësaj Marrëveshjeje ose një marrëveshjeje tjetër të parashikuar në të ose përfitim e një shume të kërkueshme nga Banka për qëllimin e raportimit të Donatori.

Seksioni 8.09 **Kopjet**

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në tri kopje në gjuhën angleze, secila prej të cilave konsiderohet origjinale, por të gjitha përbëjnë një dhe të vetmen marrëveshje.



Në dëshmi të kësaj, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë realizuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje në tri kopje në datën e parë të shkruar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Emri:

Titulli:

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____

Emri:

Titulli:

**GRAFIKU 1
KATEGORITË QË FINANCOHEN NGA GRANTI**

Tabela e treguar në këtë Grafik parashikon kategoritë që financohen nga Granti, shumën e alokimit të Grantit për çdo kategori të financuar nga Granti dhe përqindjen e shpenzimeve që duhet të financohen për çdo kategori të financuar nga Granti.

	Kategoritë që financohen nga Granti	Granti IPA 2010 euro	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen	Granti IPA 2011 (euro)	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen
1	Punë për rehabilitim rruge	18.250.000	Deri në 92.4%, duke përjashtuar taksat	14.318.750	100%, duke përjashtuar taksat
2	Punë për rindërtimin e rrugëve në Rajonin e Shkodrës	1.500.000	Deri në 7.6%, duke përjashtuar taksat	0	
	TOTALI	19.750.000	100%	14.318.750	100%

**SHTOJCA 1
FORMA E KËRKESËS SË LIVRIMIT**

Drejtuar:

Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

One Exchange Square

London EC2A 2JN

United Kingdom

Në vëmendje të: Departamentit të Administrimit të Operacioneve

Operacioni nr. 40153 (Komponent i Grantit)

Kërkesë Livrimi nr. (1)

Lënda: Marrëveshje Granti datë ____ 2013, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka).

Ne kërkojmë livrimin e mëposhtëm në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit të përmendur më sipër:

Monedha e Grantit: euro

Monedha e Pagesës që kërkohet: (2)

- Shuma(t) e financuara/monedha: (3)
- Data e Llogaritjes: (4)
- E pagueshme për (Përftuesi): (5)
- Udhëzimet e Pagesës (Hollësi Bankare të Përftuesit):
- Emri i Llogarisë së Përftuesit: (6)
- Numri i Llogarisë së Përftuesit: (7)
- Emri i Bankës së Përftuesit: (8)
- Adresa e Bankës së Përftuesit: (9)
- Hollësi të Korrespondentit të Bankës së Përftuesit:
- Emri i Bankës Korrespondente: (10)
- Adresa: (11)
- Emri i Llogarisë: (12)
- Numri i Llogarisë: (13)
- Referenca e Pagesës: (14)

Ne vërtetojmë që në nuk kemi kërkuar më parë livrime nga Granti për të mbuluar këto shpenzime. Në nuk kemi marrë dhe nuk kemi ndërmend të marrim fonde për këtë qëllim nga shumat e ndonjë Granti, kredie apo huaje tjetër.

Mallrat dhe shërbimet e mbuluara nga kjo kërkesë janë blerë ose po blihen në pajtim me termat e Marrëveshjes së Grantit.

Ne konfirmojmë që pas këtij Livrimi, shuma e plotë e Grantit të livruar nuk do të kalojë (*) % të shumës së plotë të livruar më parë ose njëkohësisht sipas Marrëveshjes së Huas.

Ne i konfirmojmë BERZH-it që: i) në jemi në pajtim me detyrimet tona, siç janë parashikuar në Marrëveshjen e Grantit dhe Marrëveshjen e Huas; dhe ii) që nuk ka ndodhur asnjë ngjarje që mund të ndikojë materialisht dhe negativisht operacionet tona ose gjendjen financiare ose aftësinë tonë për të përmbushur Projektin ose për të përmbushur detyrimet tona sipas Marrëveshjes së Grantit.

- Sinqerisht juaji,
- (Nënshkrimi(et)) për dhe në emër të (15)
- Bashkëngjitur: - Numri i plotë i formularëve përmbledhës: (16)
- Numri i plotë i artikujve të dokumentit: (17)

Shënime për mbushjen e formularit të kërkesës së livrimit

1. Përfituesi duhet të numërtojë çdo formular kërkesë. Kërkesa e parë për një livrim Granti do të numërtohet 1, ndërsa kërkesat pasuese do të numërtohen 2, 3 etj. I takon përfituesit të respektojë numërtimin e të gjitha kërkesave për livrimin e Grantit që ai ka bërë sipas kësaj marrëveshje Granti. Formularët e kërkesave duhet të ndjekin të njëjtin sistem numërtimi pasues, qofshin si livrim i pagesës së drejtpërdrejtë apo për lëshimin e një detyrimi rimbursimi. Përdorimi i këtij sistemi numërtimi mënjanon ngatërresat në rastin kur formularët mbahen në postë, dërgohen me faks më shumë se një herë etj.

2. Jeni të lutur të përcaktoni monedhën e pagesës faktike të kërkuar. Kjo do të jetë monedha e Grantit ose monedha e shpenzimeve (shih (3) më poshtë). Si alternativë, në disa rrethana Banka mund të bjerë dakord të paguajë një monedhë të tretë, dhe në këtë rast do të vepronte si agjent i përfituesit për të përftuar këtë monedhë.

Nëse pagesa kërkohet në më shumë se një monedhë, atëherë duhet të paraqitet një formular i ndryshëm kërkesë për çdo monedhë.

3. Shumat e financuara janë shpenzimet origjinale, në monedhën e tyre origjinale të detajuara në formularin përmbledhës, të llogaritur në përqindjen e përshtatshme të specifikuar në marrëveshjen e Grantit për Zërin e përshtatshëm dhe të zbatueshëm të Financuar nga Granti. Shumat e dhëna duhet të përputhen me shumat e plota në seksionin (15) të formularit përmbledhës.



4. Data e llogaritjes është data që llogaria e BERZH-it debitohet me pagesën e shumës së livrimit. BERZH-i nuk mund të garantojë që llogaria e përfuturit do të kreditohet në të njëjtën datë, pasi kjo varet nga procedurat e zbatuara nga sistemi i verifikimit ose banka pritëse në vendin e përfuturit. Duhet të ketë minimalisht 15 ditë pune ndërmjet datës që BERZH-i merr kërkesën dhe datës së llogaritjes së kërkuar. Nëse në fakt pagesa nevojitet sa më shpejt të jetë e mundur, në vend të një date llogaritjeje specifike, mund të jetë më mirë për të mos dhënë një datë specifike, por të vendoset në kuti “sa më shpejt të jetë e mundur” (4). Në këtë rast, BERZH-i do të bëjë pagesën në çdo rast brenda 15 ditëve pune, por sa më shpejt të jetë e mundur. (Jeni të lutur të vini re që pagesa mund të garantohet brenda 15 ditëve pune nëse kërkesa për livrim është e saktë dhe e plotë.)

5. Livrimi i paguhet përfuturit. Normalisht përfuturi do të jetë Kontraktori, por me kusht që Banka të ketë rënë dakord ndryshe me shkrim dhe dokumentacioni i përfshirë (shihni formularin përmbledhës) jep prova që huamarrësi e ka paguar Kontraktorin, pagesa mund t’i bëhet Përfuturit.

6. Emri i llogarisë së përfuturit në shumicën e rasteve do të jetë emri i përfuturit.

7. Numri i llogarisë së përfuturit kërkohet për të mënjeluar vonesat. Në një numër në rritje vendesh, bankat do të refuzojnë të bëjnë pagesa nëse numri i llogarisë së përfuturit nuk jepet në udhëzimet e pagesës.

8. Banka e përfuturit është banka ku mbahet llogaria e përfuturit. Jeni të lutur të tregoni emrin e bankës dhe qytetin.

9. Në vend të adresës, mund të jepet kodi i dallues ose kodi SWIFT.

10. Banka korrespondente e bankës së përfuturit kërkohet vetëm nëse pagesa nuk bëhet në monedhën e vendit ku gjendet banka e përfuturit. Në këtë rast, banka korrespondente është banka që gjendet në vendin e monedhës së pagesës, me të cilën banka e përfuturit ka një llogari.

11. Në vend të një adrese, mund të jepen kodi dallues ose kodi SWIFT i bankës korrespondente.

12. Emri i llogarisë së Bankës së Përfuturit në shumicën e rasteve do të jetë emri i Bankës së Përfuturit.

13. Numri i llogarisë së bankës së përfuturit është i domosdoshëm nëse Banka e Përfuturit ka më shumë se një llogari me bankën korrespondente, ose nëse nuk është anëtare e SWIFT-it (sistemi ndërkombëtar i kryerjes së pagesave elektronike). Përndryshe ky numër është i dobishëm, por jo detyrues. Sipas rastit, duhet të citohet edhe numri IBAN (Numri Ndërkombëtar i Llogarisë Bankare).

14. Referenca e pagesës që do të dërgojë BERZH-i me pagesën ndihmon përfuturin të identifikojë pagesën. Nëse nuk kërkohet ndonjë referencë specifike, BERZH-i do të përmendë emrin e Përfuturit dhe numrin e marrëveshjes.

15. Nënshkrimi. Formulari përmbledhës i kërkesës duhet të nënshkruhet nga ose në emër të Përfuturit.

16. Formularët përmbledhës rendisin të gjithë artikujt e dokumentacionit që përfshihen për të mbështetur kërkesën për Livrim. Nëse ka shumë artikuj, është e këshillueshme të përdoret një formular i veçantë për çdo kategori.

17. Artikujt e dokumentacionit (kontratat, faturat etj.) duhet të numërtohen dhe paraqiten në të njëjtin rend siç paraqiten në formularët përmbledhës. Numri i tyre i përgjithshëm duhet të tregohet për të lehtësuar rishikimin nga BERZH-i.

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Emri i Përfutësit: (1) Nr. i operacionit: (3) Nr. i kërkesës: (4).....

Datë: (2) Nr. i formularit (5) Livrimi (nr. i ref./emri/%)
Zë i financuar nga/...../.....
granti (6)

Artikulli nr.	Përshkrimi i artikullit	Kontrata nr. dhe data	Emri dhe adresa e kontraktorit	Përshkrim i shkurtër i mallrave, punëve ose shërbimet	Monedha dhe totali Shuma e kontratës	Monedha dhe shuma e shpenzime të përshtatshme	Shuma e financimi në monedhën e shpenzimeve
(7)	(8)	(9)	(10)	(11)	(12)	(13)	(14)

Nënshkrimi
(16)

TOTALI (për monedhë)
(15)



Shënime për mbushjen e formularit përmbledhës të kërkesës për livrim

1. Emri. Emri i Përfituesit. Ky duhet të jetë e njëjtë, si dhe në formularin e kërkesës së livrimit që i përket ky formular përmbledhës.

2. Data. Data e kërkesës. Kjo duhet të jetë e njëjtë, si dhe në formularin e kërkesës së livrimit që i përket ky formular përmbledhës.

3. Numri i operacionit. Ky numër është i njëjtë, si dhe në formularin e kërkesës së livrimit që i përket ky formular përmbledhës.

4. Numri i kërkesës. Ky është numri i kërkesës së livrimit që i përket ky formular përmbledhës.

5. Numri i formularit përmbledhës. Për çdo kërkesë livrimi, formularët përmbledhës duhet të numërtohen duke filluar nga 1 dhe numri i tyre total të shënohet në formularin e kërkesës së livrimit që i përket.

6. Zëri i financuar nga granti i livruar. Ky është zëri i financuar nga granti për projektin që duhet të financohet nga shumat e livrimit të kërkuar. Jeni të lutur të shihni marrëveshjen e grantit për të gjetur emrin dhe numrin e referencës të zërit të financuar nga granti dhe përqindjen e shpenzimeve për t'u financuar (për shembull, zë i financuar nga granti nr. (3b), pajisje, 60%).

Nëse një kërkesë livrimi mbulon shpenzime nga më shumë së një zë i financuar nga granti, duhet të përdoret një formular i veçantë përmbledhës për çdo zë të financuar nga granti.

7. Numri i artikullit. Të gjithë artikujt dokumentues (fatura, kontrata etj.) duhet të paraqiten në të njëjtin rend siç shfaqen në formularët përmbledhës. Për të lehtësuar identifikimin, dokumentet duhet të numërtohen, duke filluar me 1, 2, 3 etj., për çdo kërkesë të re livrimi, dhe ky numër duhet të shënohet qartë në vetë dokumentin. Numri i plotë i zërave për të gjithë formularët përmbledhës shënohet në formularin e kërkesës për livrim.

8. Përshkrimi i artikullit. Jeni të lutur të përshkruani çdo artikull, p.sh.: “faturë”, “certifikatë inxhinieri”, “përkthim i (...)” etj.

9. Numri rendor i kontratës dhe data. Rekomandohet që kontratës t'i vihet një numër origjinal nëse përpilohet ndërmjet Përfituesit dhe kontraktorit. BERZH-i do të përshtatë këtë numër për mbajtjen e regjistrave të saj. Nëse kontratës nuk i është dhënë një numër origjinal, BERZH-i do t'i caktojë asaj një numër dhe vë në dijeni Përfituesin në momentin e aprovimit. Nëse Përfituesi nuk e di numrin në momentin e mbushjes së formularit përmbledhës, kjo pjesë mund të lihet të plotësohet nga BERZH-i.

Data e kontratës/porosisë së blerjes duhet të vendoset në këtë kolonë.

Shënim. E njëjta kontratë mund të shfaqet në më shumë së një kërkesë livrimi, nëse dorëzimi i mallrave, punëve ose shërbimeve (shih (11)) dhe pagesa për këto mallra etj., është bërë me etapa.

10. Emri dhe adresa e kontraktorit. Emri dhe adresa e homologut të Përfituesi (kontraktorit) në kontrata/porosinë e blerjes siç përshkruhet të (9).

11. Përshkrim i shkurtër i mallrave, punëve ose shërbimeve. Këto mallra, punë ose shërbime duhet të përputhen me hollësitë e dhëna në kontratë ose dokumentet e paraqitura dhe duhet të përfshihen brenda zërit të financuar nga granti të treguar të (6).

12. Monedha dhe shuma e plotë e kontratës. Shuma e plotë në monedhën origjinale të kontratës e renditur të (9).

13. Monedha dhe shuma e shpenzimeve të përshtatshme. Për çdo shpenzim: shuma e plotë e kërkueshme ose e paguar, në monedhën origjinale, që mbulohet nga faturat ose dokumentet e tjera të renditura në (7) dhe (8). Nëse ka më shumë së një “zë” për çdo shpenzim (p.sh.: një faturë, certifikatë, të gjitha për të njëjtin shpenzim), këta artikuj duhet të futen në kllapa dhe vetëm një shumë duhet të tregohet në këtë kolonë.

14. Shuma e financimit. Për çdo shumë të renditur në kolonën (13), duhet të ketë një shumë përkatëse në këtë kolonë (14), të llogaritur në përqindjen e caktuar të (6), që përputhet me

kategorinë e këtij formulari përmbledhës. Shuma e financimit duhet të jetë në monedhën origjinale të kontratës dhe shpenzimit (kolonat 12 dhe 13). Kjo mund të jetë ose jo e njëjta monedhë e huas ose monedha e pagesës.

15. Totali. Shumat e financimit, të renditura në (14), duhet të mbledhen në një shumë të përgjithshme për çdo monedhë. Për kërkesat e livrimit të drejtpërdrejtë, shumat e dhëna këtu duhet të përputhen me shumat e dhëna të (9) e formularit të kërkesës për livrim të drejtpërdrejtë.

16. Nënshkrimi. Formulari përmbledhës i kërkesës duhet të nënshkruhet nga ose në emër të Përfituesit. Shihni kërkesën për formular livrimi për kërkesat e nënshkrimit.

SHTOJCA 2 FORMA E LETRËS QË ÇAKTON NËNSHKRUESIT E AUTORIZUAR

(Të printohet në krye të letrës së Përfituesit)

(Datë)

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Në vëmendje të: Njësia e Administrimit të Operacioneve

Lënda: Operacioni nr. 40153 (komponent i grantit)

Letër që cakton nënshkruesit e autorizuar¹

E dashur zonjë/zotëri,

Në lidhje me marrëveshjen e grantit të datës _____ 2012 (marrëveshja e grantit), ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Përfituesi) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), jeni të lutur të vini re që secili prej personave, ekzemplarët e vërtetuar të nënshkrimeve të cilëve shfaqen më poshtë, është i autorizuar që në emër të Përfituesit të nënshkruajë kërkesa livrimi dhe çdo njoftim apo dokument tjetër që kërkohet ose lejohet të nënshkruhet sipas marrëveshjes së grantit të përmendur më sipër.

EMRI	POZICIONI	EKZEMPLARI I NËNSHKRIMIT
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

Të gjitha njoftimet e mëparshme që përmbajnë nënshkrimet e nëpunësve të autorizuar për të nënshkruar në emër të Përfituesit sipas marrëveshjes së mësipërme të grantit revokohen.

Sinqerisht juaji,

Për dhe në emër të:

Nga: _____

Emri:

Titulli:

¹ Përcaktimi mund të ndryshohet nga Përfituesi në çdo kohë duke paraqitur një letër të re nënshkruesit e caktuar të autorizuar të Banka.



Shënime për mbushjen e letrës që cakton nënshkruarit e autorizuar

- Letra e mësipërme e autorizimit duhet të nënshkruhet në emër të Përfituesit nga nëpunësi i specifikuar në marrëveshjen e grantit (shihni “Njoftimet dhe përfaqësuesit e autorizuar” ose të barasvlershmen).

- Në rast së çdo dokument duhet të nënshkruhet nga më shumë së një nëpunës, letra e autorizimit duhet ta thotë këtë qartë dhe fjalia e parë duhet të përshtatet përkatësisht.

Nëse nënshkruarit e autorizuar janë ndarë në dy grupe dhe kërkohet nënshkrimi i një nëpunësi nga secili grup, kjo duhet të shprehet, gjithashtu, qartë.

SHTOJCA 3 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i projektit është të asistohet Huamarrësi në rehabilitimin e deri në 500 km të rrjetit rrugor rajonal dhe lokal në Shqipëri.

2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, duke iu nënshtruar atyre modifikimeve që Banka dhe Huamarrësi mund të bien dakord herë pas here:

Pjesa A: Përgatitja e projekteve inxhinierike

Pjesa B: Punët civile për rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe lokale

Punët për pjesën B të projektit, duke përfshirë tatimet, do të bashkëfinancohet nga grantet EIB dhe IPA 2010 dhe IPA 2011. Huamarrësi do të financojë përfundimin e tokës dhe të gjitha tatimet në lidhje me pjesën B të projektit (duke përfshirë në lidhje me kontratat e punëve civile).

Pjesa C: Mbikëqyrja e punëve të ndërtimit për projektin e përmendur në pjesën B, sapo të ketë skaduar kontrata për mbikëqyrjen financuar nga Banka Botërore, e cila do të financohet nga grantet WBIF TC.

Do të emërohet një konsulent mbikëqyrës, i cili do të monitorojë zbatimin e punëve sipas pjesës B të projektit.

Pjesa D: Monitoruesi i Huadhënësit

Do të caktohet një monitorues i Huadhënësit, i cili do të monitorojë zbatimin e projektit në emër të bankave.

Pjesa E: Mbështetja e zbatimit

Do të caktohet një konsulent, i cili do të japë mbështetje zbatimi për FSHZH-në; dhe

Pjesa F: Konsulentë për përmirësimin e mirëmbajtjes së rrugëve lokale

Do të caktohen konsulentë për të asistuar FSHZH-në në përmirësimin e mirëmbajtjes së rrugëve lokale.

Shërbimet sipas pjesëve A, D, E dhe F do të financohen nga grantet WBIF TC.

3. Projekti pritet të përfundojë brenda 31 dhjetorit 2015.

VENDIM Nr. 1049, datë 4.12.2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pjesën I, titulli II, kreu I, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Neni 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 3

Organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është 1002 punonjës, të shpërndarë në nivel qendror dhe vendor. Struktura organike dhe analitike e administratës doganore është sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3.1 Organika e administratës doganore, në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 13 të Kodit Doganor, është e përbërë, si më poshtë vijon:

a) Drejtori i Përgjithshëm, i barasvlefshëm me kategorinë “Nëpunësi civil i nivelit të lartë drejtues”;

b) Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm, i barasvlefshëm me kategorinë “Nëpunësi civil i nivelit të lartë drejtues”;

c) Kategoria A, e barasvlefshme me kategorinë “Nëpunësi civil i nivelit të mesëm drejtues”;

ç) Kategoria B, e barasvlefshme me kategorinë “Nëpunësi civil i nivelit të ulët drejtues”;

d) Kategoria C1, e barasvlefshme me kategorinë “Nëpunësi civil i nivelit ekzekutiv”;

dh) Kategoria C2, e barasvlefshme me kategorinë “Nëpunësi civil i nivelit ekzekutiv”;

e) Kategoria C3, personel doganor i nivelit të ulët;

ë) Kategoria D1, personel ndihmës;

f) Kategoria D2, personel i shërbimit të mirëmbajtjes;

g) Kategoria D3, personel sanitar.

3.2 Në zbatim të paragrafit të tretë të nenit 13 të Kodit Doganor, funksionet dhe detyrat e personelit të administratës doganore janë, si më poshtë vijon:

a) Drejtori i Përgjithshëm. Është kreu dhe struktura më e lartë e administratës doganore shqiptare që siguron administrimin e efektshëm të saj dhe drejton, bashkërendon e mbikëqyr veprimtarinë e administratës doganore dhe i raporton drejtpërdrejt ministrit të Financave për ecurinë e punës.

Përveç përgjegjësive të parashikuara në Kodin Doganor, drejtori i Përgjithshëm propozon dhe dërgon për miratim strategjinë doganore të biznesit të administratës doganore, planin e menaxhimit të ndryshimeve në biznes, ndryshimin e strukturës organizative, rregulloren e brendshme të administratës doganore, si dhe zbaton strategjitë dhe adreson përgjegjësitë në të gjitha nivelet e administratës, në varësi të nevojave apo të rrethanave specifike.

Gjithashtu, miraton rregulloret e funksionimit të degëve doganore, rregulloret specifike të funksionimit të drejtorive, si dhe akte të tjera të nivelit të tretë, në varësi të nevojave të punës.

Për të siguruar administrimin efektiv dhe përmbushjen e misionëve, kompetencave dhe detyrave funksionale të administratës doganore, bashkëpunon dhe bashkërendon punën, nëpërmjet zëvendësdrejtorëve dhe drejtuesve, që ka në varësi të drejtpërdrejtë.

b) Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm. Është drejtuesi i një departamenti që siguron administrimin e efektshëm, si dhe drejton, bashkërendon punën e mbikëqyr veprimtarinë e kryer nga drejtoritë e departamentit që mbulon. Ai ushtron funksionet e kompetencat sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për këtë pozicion, si dhe funksionet e përgjegjësive që i delegohen këtij posti.

c) Kategoria A. Në këtë kategori përfshihen: këshilltar, drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, drejtor Drejtorie Rajonale, kryetar i Degës Doganore Tiranë, kryetar i Degës Doganore Durrës, kryetar i Degës Doganore Vlorë, kryetar i Degës Doganore Gjirokastrë (Kakavi), kryetar i Degës Doganore Shkodër, kryetar i Degës Doganore Rinas.



Punonjësit e kësaj kategorie, me emërtesën këshilltar, kryejnë funksione këshillimore, si dhe mbështetin e ndihmojnë drejtorin e Përgjithshëm, sipas fushave specifike që ato mbulojnë, bashkërendojnë punën dhe bashkëveprojnë me strukturat e tjera.

Punonjësit e tjerë të kësaj kategorie drejtojnë, bashkërendojnë, mbikëqyrin dhe sigurojnë administrimin e efektshëm të veprimtarisë së strukturës që drejtojnë, si dhe ushtrojnë funksionet e përgjegjësitë që i delegohen këtij posti.

ç) Kategoria B. Në këtë kategori përfshihen: përgjegjës sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale, përgjegjës sektori në degët doganore Tiranë e Durrës, kryetar i një dege doganore që nuk është pëfshirë në përcaktimin e shkronjës “c”, më sipër.

Punonjësit e kësaj kategorie drejtojnë, bashkërendojnë punën, mbikëqyrin dhe sigurojnë administrimin e efektshëm të veprimtarisë së strukturës që drejtojnë, si dhe ushtrojnë funksionet e përgjegjësitë që i delegohen këtij posti.

d) Kategoria C1. Në këtë kategori përfshihen: specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, specialist në degën doganore, specialist administrator i rrejtës së teknologjisë së informacionit, specialist auditit, komandant grupi, përgjegjës zyre, përgjegjës turni/grupi, financiar në degë doganore, përkthyes, specialist i marrëdhënieve ndërkombëtare.

Punonjësit e kësaj kategorie i ushtrojnë detyrat dhe funksionet e tyre në të gjithë administratën doganore bazuar në funksionet dhe specifikat e strukturës ku ato veprojnë dhe në përputhje me legjislacionin e aktet normative në fuqi, si dhe kryejnë funksionet e përgjegjësitë të deleguara. Punonjësit, që ushtrojnë funksionet komandant grupi, përgjegjës zyre, përgjegjës turni/grupi, kanë për detyrë, gjithashtu, të sigurojnë bashkërendimin e punës dhe sigurimin e efektshmërisë në veprimtarinë e kryer nga zyra apo sektori/grupi të cilin drejtojnë/udhëheqin.

dh) Kategoria C2. Në këtë kategori përfshihen: doganier/klasifikim/vlerësim/kontroll fizik/skaner/akcize/regjime/preferenca/përrjashtime, inspektor, specialist i nivelit të dytë, asistent laborant.

Punonjësit e kësaj kategorie ushtrojnë funksione lidhur me gjithë veprimtarinë dhe procedurat doganore, kontrollet dhe mbikëqyrjen doganore në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, si dhe ushtrojnë funksionet e përgjegjësitë të deleguara.

e) Kategoria C3. Në këtë kategori përfshihen: arkivist, sekretar, doganier peshoreje, pikë kontrolli dhe përpunues informacioni.

Punonjësit e kësaj kategorie ushtrojnë funksione lidhur me administrimin e korrespondencës e të dokumentacionit, si dhe ruajtjen e tij, me procedurat e peshimit e të kontrollit doganor, mbrojtjen e sigurinë dhe me përpunimin e informacionit doganor, si dhe ushtrojnë funksionet dhe përgjegjësitë të deleguara.

ë) Kategoria D1. Në këtë kategori përfshihet personeli ndihmës: magazinier, teknik, shofer.

Punonjësit e kësaj kategorie ushtrojnë funksione lidhur me ruajtjen e bazës materiale dhe furnizimin, kryerjen e shërbimeve të ndryshme teknike, sigurimin e lëvizjes së sigurt të personelit doganor.

f) Kategoria D2. Personeli tjetër ndihmës, që kryen shërbimet të mirëmbajtjes së zyrave.

Këta punonjës ushtrojnë funksione lidhur me mirëmbajtjen e ambienteve të zyrave, si dhe kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes.

Marrëdhëniet e punës për personelin e kategorive D1 e D2 rregullohen nga dispozitat e Kodit të Punës.

g) Kategoria D3. Personeli që kryen shërbime sanitare.

Këta punonjës ushtrojnë funksione lidhur me mirëmbajtjen dhe shërbimet sanitare në ambientet e punës.

3.3 Drejtori i Përgjithshëm, në varësi të organikës së miratuar nga Këshilli i Ministrave, sipas nevojave operacionale, i propozon ministrit të Financave strukturën organizative dhe analitike.

Ky propozim, pas miratimit të ministrit të Financave, dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave.”.

b) Në shkronjën “ç” të pikës 3 të nenit 4.1, pas fjalëve “... nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë ...” shtohen “... detajimin e planit të të ardhurave ...”.

c) Në pikën 7.5 të nenit 7, fjalia “... përgatit planin vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe të përdorimit të burimeve financiare ...” zëvendësohet me “... përgatit kërkesat buxhetore dhe të përdorimit të burimeve financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ...”.

ç) Pas pikës 7.5, të nenit 7, shtohet pika 7.6, me këtë përmbajtje:

“7.6. Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm

Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm është organ mbështetës dhe ndihmës i drejtorit të Përgjithshëm, me funksion këshillimor të lidhur me:

- elementet teknike dhe procedurale doganore;
- zbatimin e projekteve, në të cilat përfituese është administrata doganore, dhe stimulimin e shtimit të nivelit të asistencës;
- vlerësimin dhe përmirësimin e elementeve të shërbimeve të teknologjisë së informacionit;
- mundësimin e transparencës mediatike për opinionin publik dhe kryesisht komunitetin e biznesit lidhur me risitë, nismat dhe zhvillimet e administratës doganore.”.

2. Në pjesën I, titulli II, kreu III, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 11.2 dhe 11.3, të nenit 11, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“11.2. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në zbatim të strukturës organike të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe të nevojave operacionale, shpall vendet vakante. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, me propozimin e drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, miraton procedurën e konkurrimit për vendet e shpallura vakante.

11.3. Përzgjedhja e kandidatëve për vendet vakante bazohet në parimin e vlerësimit të përshtatshmërisë së tyre në raport me kërkesat e përshkrimit të vendit të lirë të punës dhe përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Përfundim nga kriteret e përcaktuara në këtë aneks, për të gëzuar pozicionet në nivelet A, B, C1, C2, të administratës doganore, përbëjnë rastet e mëposhtme:

- a) Rekrutimi i punonjësve të teknologjisë së informacionit;
- b) Rekrutimi i punonjësve të antikontrabandës detare/tokësore;
- c) Rekrutimi i punonjësve të informacionit;
- ç) Rekrutimi i punonjësve të antitrafikut;
- d) Rekrutimi i punonjësve të laboratorit doganor;
- dh) Rekrutimi i punonjësve të Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse;
- e) Rekrutimi i punonjësve të Drejtorisë së Marrëdhënive me Jashtë;
- ë) Rekrutimi i punonjësve të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- f) Rekrutimi i punonjësve të Drejtorisë së Analizës së Riskut dhe Monitorimit;
- g) Rekrutimi i punonjësve të Departamentit të Akcizës;
- gj) Ngritja në kategori e punonjësve me përvojë me më shumë se 5 (pesë) vjet në strukturat doganore dhe me kualifikime të shumta në fushën e doganave.”.

b) Aneksi 1, i përmendur në nenin 11, zëvendësohet me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në pjesën I, titulli II, kreu VI, pikat 18.1.1 – 18.1.3, të nenit 18, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“18.1.1. Në rast dyshimi për kryerjen e një shkeljeje nga një punonjës doganor, eprori direkt bën verifikimet e nevojshme në lidhje me rastin dhe, kur është e nevojshme, merr deklaratime nga çdo dëshmitar i mundshëm dhe evidenton provat e nevojshme dokumentare (në rast se ka). Në rast se, në përfundim të verifikimit, eprori direkt vlerëson se ndodhet përpara një shkeljeje të kryer nga ana e punonjësit, përgatit një material me shkrim (material relatues), ku evidenton këtë shkelje



dhe e dërgon atë brenda 10 (dhjetë) ditësh pranë Komitetit Disiplinor. Materiali duhet të bashkëshoqërohet edhe me të gjitha provat dokumentare (në rast se ka).

18.1.2. Komiteti Disiplinor, pas marrjes së materialit me shkrim nga eprori direkt i punonjësit, brenda 20 (njëzet) ditësh vlerëson paraprakisht çështjen dhe materialin relatues. Në rast së konstatohet mangësi në informacion apo nevojitet dokumentacion shtesë, Komiteti Disiplinor i kërkon strukturës konstatuese (relatuese) dokumentacion shtesë.

18.1.3. Komiteti Disiplinor, pasi vlerëson çështjen, materialin relatues, si dhe dokumentacionin provues, organizon një seancë dëgjimore, gjatë së cilës punonjësi që pretendohet se ka kryer shkelje ka të drejtë të japë shpjegime, të japë dokumentacion provues për të vërtetuar se veprimet e tij nuk janë në shkelje të legjislacionit në fuqi, t'u përgjigjet pyetjeve të ndryshme që ngrihen rreth ngjarjes, si dhe të kundërshtojë me argumente dhe prova materialin relatues. Punonjësi, ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor, ka të drejtë të mbrohet përmes përfaqësuesit të tij ligjor me shpenzimet e tij. Punonjësi, ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor, si dhe personat e tjerë që kanë lidhje me çështjen (dëshmitarë, eprori direkt, përfaqësuesi ligjor, në rast se është kërkuar një i tillë), njoftohen nominalisht për të marrë pjesë në seancën dëgjimore. Njoftimi i punonjësit bashkëshoqërohet gjithmonë edhe me një kopje të materialit relatues të eprorit direkt. Njoftimi përmban elementet e nevojshme informuese për vendin dhe orën e zhvillimit të seancës dëgjimore. Njoftimi përfshihet në dosjen e seancës së Komitetit Disiplinor dhe është pjesë e saj.”

4. Në pjesën I, titulli II, krrerët I - VI, emërtesa “Drejtoria e Administrimit të Personelit dhe Trajnimit”, zëvendësohet me “Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIDHJA NR.1
STRUKTURA ORGANIKE DHE ANALITIKE E ADMINISTRATËS DOGANORE

	Emërtimi i postit	Kodi i zyrës	Funksioni	Kategoria	Nr.i punonjësve	Kategoria e pagës	
0	Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm	1000	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1	II-a	
			Këshilltar teknik	A	1	III-a	
			Këshilltar për inovacionin	A	1	III-a	
			Këshilltar për projektet	A	1	III-a	
			Këshilltar për komunikimin	A	1	III-a	
			Specialist i nivelit të dytë	C2	1	IV-a	
	Totali i Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm					6	
	Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe me Publikun	1400	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
			Specialist i marrëdhënieve ndërkombëtare	C1	1	III-b	
			Përkthyes	C1	1	III-b	
			Specialist për marrëdhëniet me shtypin dhe publikun	C1	1	III-b	
			Specialist për menaxhimin e projekteve	C1	1	III-b	
	Totali i drejtorisë					5	
	Drejtoria e Auditimit të Brendshëm	1500	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
			Specialist auditit	C1	7	III-b	
Totali i drejtorisë					8		
Drejtoria e Investigimit të Brendshëm dhe Antikorupsionit	1530	Drejtor drejtorie	A	1	III-a		
		Specialist	C1	4	III-b		
Totali i drejtorisë					5		
Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës	1140	Drejtor drejtorie	A	1	III-a		
	Sektori i Buxhetit	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1		
		Specialist	C1	2	III-b		
Sektori i Financë/Kontabilitetit	1142	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1		

			Specialist	C1	1	III-b	
			Specialist i nivelit të dytë	C2	5	IV-a	
			Magaznier	D1	2		
Totali i drejtorisë					13		
Totali i Zyrës së Drejtorit dhe drejtorive në varësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm					37		
Departamenti Teknik	1200		Zv/Drejtor i Përgjithshëm	II-b	1	II-b	
			Sekretar	C3	1		
Total					2		
Drejtoria e Procedurave, Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore	Sektori i Procedurave	1210	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
		Sektori i Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore	1211	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
	1212		Specialist	C1	4	III-b	
			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
	1212	Specialist	C1	2	III-b		
Totali i drejtorisë					10		
Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës	Sektori i Tarifës	1220	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
		Sektori i Origjinës	1221	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
	1222		Specialist	C1	3	III-b	
			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
	1222	Specialist	C1	3	III-b		
Totali i drejtorisë					9		
Drejtoria Juridike	Sektori i Legjislacionit	1230	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
		1231	Përpunues informacioni	C3	1		
	Përgjegjës sektori		B	1	III-a/1		
	Specialist legjislacioni		C1	3	III-b		
	Sektori i Ankimimeve	1232	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
			Specialist jurist	C1	5	III-b	
Totali i drejtorisë					12		
Drejtoria e Labororit Doganor	Sektori i Standardeve, Metodikave dhe Administrimit	1250	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
		1251	Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1		
	Përpunues informacioni		C3	1			
	Përgjegjës sektori		B	1	III-a/1		
	Specialist laborante		C1	2	III-b		
	Sektori i Analizave	1252	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
Specialist laborante			C1	6	III-b		
			Asistentë laborante	C2	6	IV-a	
Totali i drejtorisë					19		
Drejtoria e Vlerës Doganore	Sektori i Mbikëqyrjes së Vlerës Doganore	1260	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
		1261	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
	Sektori i të Dhënave të Disponueshme		1262	Specialist	C1	2	III-b
			1262	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
	1262	Specialist		C1	2	III-b	
Totali i drejtorisë					7		
Totali i Departamentit Teknik					59		
Departamenti i Akcizës			Zv/Drejtor i Përgjithshëm	II-b	1	II-b	
			Sekretar	C3	1		
Totali					2		
Drejtoria Teknike e Akcizës	Sektori i Autorizimeve	1610	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
		1611	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
	Specialist		C1	2	III-b		
	Përgjegjës sektori		B	1	III-a/1		
	Sektori i Aplikacioneve	1612	Specialist	C1	3	III-b	
			Specialist i nivelit të dytë	C2	1	IV-a	
	Sektori i Pajisjeve Matësve dhe Linjave Teknologjike	1613	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
			Specialist	C1	4	III-b	
Totali i drejtorisë					14		
Drejtoria e Metodikave dhe Kontrollit	Sektori i Pijeve Alkoolike	1620	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
		1621	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
	Specialist		C1	4	III-b		
	Përgjegjës sektori		B	1	III-a/1		
	Sektori i Produkteve Energjetike	1622	Specialist	C1	2	III-b	
			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
Sektori i Produkteve të Tjera	1622	Specialist	C1	2	III-b		
Totali i drejtorisë					12		
Totali Departamentit të Akcizës					28		
Departamenti Operativ Hetimor	1300		Zv/Drejtor i Përgjithshëm	II-b	1	II-b	
			Sekretar	C3	1		
Total					2		



Drejtoria e Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit	Sektori i Antikontrabandës Tokësore	1320	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
		1321	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
			Komandante grupi antikontrabande	C1	16	III-b	
	Sektori i Antikontrabandës Detare	1322	Inspektor antikontrabande	C2	40	IV-a	
			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
			Komandant motovedete	C1	4	III-b	
			Specialist logjistike (inxhinier)	C1	1	III-b	
			Specialist i Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare	C1	5	III-b	
			Inspektor i antikontrabandës detare	C2	13	IV-a	
			Magazininier	D1	1		
	Sektori i Rikuperimit me Forcë të Borxhit	1323	Teknik marine/motorist	D1	5		
			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
	Totali i drejtorisë					91	
Drejtoria Antitrafik		1370	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
			Specialistë i luftës kundër armëve konvencionale dhe dëmtimit në mase	C1	2	III-b	
			Specialist i luftës kundër drogave dhe lëndëve të tjera	C1	2	III-b	
			Specialist i luftës kundër trafikut të automjeteve dhe veprave të artit	C1	2	III-b	
			Specialisti i luftës kundër parandalimit dhe pastrimit të parave	C1	1	III-b	
Totali i drejtorisë					8		
Drejtoria e Hetimit		1330	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
			Përpunues informacioni	C3	1		
			Specialist hetues	C1	14	III-b	
			Oficer të Policisë Gjyqësore		8		
Totali i drejtorisë					24		
Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale		1380	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
			Specialist	C1	4	III-b	
Totali i drejtorisë					5		
Drejtoria e Kontrollleve Paszhoganimit (aposteriori)	Sektori i Kontrollit, Vlerës/klasifikimit/originës	1340	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
		1341	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
	Sektori Kontrollit të Regjimeve Doganore	1342	Specialist	C1	4	III-b	
			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
Totali i drejtorisë					11		
Drejtoria e Informacionit		1350	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
		1351	Përfaqësues në SECI	A	1	III-a	
			Përpunues informacioni	C3	1		
	Sektori i Inteligjencës Operative			Përgjegjës Sektori	B	1	III-a/1
				Specialistë të analistëve	C1	1	III-b
				Specialistë të kërkimeve	C1	8	III-b
				Specialistë MFF	C1	1	III-b
				Specialistë MTO	C1	1	III-b
				Specialist i Zyrës së Evidencës Operative	C1	1	III-b
	Sektori i Shkëmbimit të Informacionit	1354	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
			Specialist	C1	6	III-b	
Totali i drejtorisë					23		
Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit	Sektori i Monitorimit	1360	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
			Specialistë të monitorimit	C1	13	III-b	
	Sektori i Analizës së Riskut		Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
			Specialist Analizë Risku	C1	6	III-b	
Totali i drejtorisë					22		
Totali i Departamentit Operativ Hetimor						186	
Departamenti Administrativ		1100	Zv/Drejtor i Përgjithshëm	II-b	1	II-b	
			Sekretar	C3	1		
Total					2		
Drejtoria e Menaxhimit të burimeve njerëzore	Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	1111	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
			Specialist i burimeve njerëzore	C1	2	III-b	
	Zyra e Sekretari/Protokollit dhe Arkivit	1112	Specialistë trajnimi	C1	2	III-b	
			Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	
			Sekretar/protokolli	C3	2		
			Arkivist	C3	2		

		Totali i drejtorisë				11		
Drejtoria e Burimeve Mbështetëse	Sektori i Investimeve & Logjistikës	1130	Drejtor drejtorie	A	1	III-a		
		1131	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1		
			Specialist investimesh	C1	1	III-b		
			Specialist logjistike	C1	3	III-b		
			Përpunues informacioni	C3	1			
			Teknik mirëmbajtjeje	D1	1			
			Teknik mirëmbajtjeje (oficina)	D1	3			
			Shofer	D1	12			
	Sanitar/punonjës pastrimi	D3	5					
	Sektori i Njësisë së Prokurimit	1133	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1		
			Specialist	C1	2	III-b		
			Totali i drejtorisë				31	
	Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit	Sektori i Sistemeve dhe Sigurisë	1121	Drejtor drejtorie	A	1	III-a	
				Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
			Specialist i sistemeve	C1	3	III-b		
Sektori i Zhvillimit		1124	Specialist i sigurisë	C1	2	III-b		
			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1		
			Specialist i SPDD-se	C1	3	III-b		
Sektori i Zgjidhjeve dhe Suportit (Help Desk)		1127	Specialist i Aplikacioneve të Tjera	C1	2	III-b		
			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1		
Sektori i Analizave		1240	Specialistë Suportit (Help Desk)	C1	4	III-b		
			Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1		
			Specialist	C1	3	III-b		
		Totali i drejtorisë				22		
		Totali Departamentit Administrativ				66		
		Totali i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave				376		
Rajoni Shkodër, Lezhë, Shkodër, Malësi e Madhe, Tropojë, Has, Pukë, Mirditë, Kukës, Mat, Dibër dhe Bulqizë	3001	Drejtoria Rajonale Shkodër		A	0			
		Specialist		C1	0			
		Total			0			
1	Dega Doganore Shkodër	Administrata	3100	Kryetar dogane	A	1	III-a	
				Specialist i analizës së riskut/aposterior	C1	1	III-b	
				Specialist jurist/borxhi	C1	1	III-b	
				Specialist administrator rrjeti	C1	1	III-b	
				Financier	C1	1	III-b	
				Sekretar/arkivist/magaziner	C3	1		
				Shofer	D1	1		
				Punëtor mirëmbajtjeje	D2	1		
				Sanitar/punonjës pastrimi	D3	1		
				Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	
	Zyra e Operacioneve Doganore	3110	Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	1			
			Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	3	IV-a		
			Përgjegjës zyre	C1	1	III-b		
	Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	3101	Doganier akcize/regjime/preferenca/përrjashtime	C2	3	IV-a		
			Përgjegjës zyre	C1	1	III-b		
	Zyra Doganore Hani i Hotit	3101	Doganier pikë kontrolli	C3	2			
			Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	9	IV-a		
	Zyra Doganore Bajzë	3102	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b		
			Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	2	IV-a		
	Zyra Doganore Murriqan	3103	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b		
			Doganier pikë kontrolli	C3	4			
			Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	4	IV-a		
			Punëtor mirëmbajtjeje	D2	1			
Sanitar/punonjës pastrimi			D3	1				
Zyra Doganore Vermosh	3104	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b			
		Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	2	IV-a			
		Totali i Degës Doganore				47		
2	Dega Doganore Lezhë	Administrata	3200	Kryetar dogane	B	1	III-a/1	
				Specialist analizë risku/aposterior	C1	1	III-b	
				Specialist jurist/borxhi	C1	1	III-b	
				Financier	C1	1	III-b	
				Sekretar/arkivist/magaziner	C3	1		
		Zyra e Operacioneve Doganore	3210	Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1		
				Përgjegjës zyre	C1	1	III-b	
				Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	2		
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	4	IV-a	
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik për karburantet	C2	2	IV-a	
Zyra e Regjimeve dhe Akcizës		Doganier akcize/regjime/preferenca/përrjashtime	C2	2	IV-a			



Totali i Degës Doganore					17			
3	Dega Doganore Bllatë (Peshkopi)	Administrata	3300	Kryetar dogane	B	1	III-a/1	
				Specialist analizë risku /aposterior/jurist/borxhi	C1	1	III-b	
				Financier	C1	1	III-b	
				Sekretar/arkivist/magaznier	C3	1		
		Zyra e Operacioneve Doganore	3310	Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
					Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
					Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	3	
					Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	6	IV-a
Totali i Degës Doganore					17			
4	Dega Doganore Kukës (Morinë)	Administrata	3400	Kryetar dogane	B	1	III-a/1	
				Specialist analizë risku/aposterior	C1	1	III-b	
				Specialist jurist/borxhi	C1	1	III-b	
				Specialist administrator rrjeti	C1	1	III-b	
				Financier	C1	1	III-b	
				Sekretar/arkivist/magaznier	C3	1		
				Shofer	D1	1		
				Punëtor mirëmbajtjeje	D2	1		
		Zyra Operacioneve Doganore	3410	Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	Sanitar/punonjës pastrimi	D3	1	
					Përgjegjës Zyre	C1	3	III-b
					Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	6	
					Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	6	IV-a
		Zyra e Skanerit	3401	Zyra e Skanerit	Doganier akcize/regjime/preferenca/përrjashtime	C2	3	IV-a
					Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik /skaneri	C2	5	IV-a
		Zyra Doganore Qafë-Prush	3401	Zyra Doganore Qafë-Prush	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
					Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	4	IV-a
		Aeroporti Kukësit	3402	Aeroporti Kukësit	Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	2	
					Përgjegjës zyre	C1	0	
		Zyra Doganore Qafë Morinë Tropojë	3403	Zyra Doganore Qafë Morinë Tropojë	Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	0	
					Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
					Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	4	IV-a
					Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	2	
		Totali i Degës Doganore					46	
		Rajoni Tiranë, Kurbin, Tiranë, Durrës, Kavajë		3002	Drejtoria Rajonale Tiranë	A	0	
			Specialist	C1	0			
			Totali i Rajonit Tiranë		0			
5	Dega Doganore Tiranë	Administrata	3500	Kryetar dogane	A	1	III-a	
				Specialist analizë risku	C1	1	III-b	
				Specialist aposterior	C1	1	III-b	
				Specialist jurist	C1	2	III-b	
				Specialist administrator rrjeti	C1	1	III-b	
				Financier	C1	1	III-b	
				Specialist i nivelit të dytë	C2	1	IV-a	
				Specialist borxhi	C1	1	III-b	
				Sekretar	C3	1		
				Arkivist	C3	2		
				Magaznier	D1	1		
				Sanitar/punonjës pastrimi	D3	1		
		Punëtor mirëmbajtjeje	D2	1				
		Sektori i Operacioneve Doganore	3510	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1	
		Zyra Peshore/Pikë Kontrolli	3501	Zyra Peshore/Pikë Kontrolli	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
					Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	8	
Zyra e Akcizës	3502	Zyra e Akcizës	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b		
			Doganier akcize	C2	9	IV-a		
Zyra Klasifikimi/vlerësimi/kontrolli fizik	3502	Zyra Klasifikimi/vlerësimi/kontrolli fizik	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b		
			Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	19	IV-a		
Zyra regjime/preferenca/përrjashtime	3503	Zyra regjime/preferenca/përrjashtime	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b		
			Doganier regjime/preferenca/përrjashtime	C2	9	IV-a		
Totali i Degës Doganore					65			
6	Dega Doganore Durrës	Administrata	3600	Kryetar dogane	A	1	III-a	
				Specialist analizë risku	C1	1	III-b	
				Specialist aposterior	C1	2	III-b	
				Specialist jurist	C1	3	III-b	
				Specialist administrator rrjeti	C1	1	III-b	
				Financier	C1	1	III-b	
				Specialist i nivelit të dytë	C2	1	IV-a	
				Specialist borxhi	C1	2	III-b	

				Sekretar	C3	1	
				Arkivist	C3	3	
				Magaznier	D1	1	
				Shofer	D1	1	
				Sanitar/punonjës pastrimi	D3	1	
				Punëtor mirëmbajtjeje	D2	1	
		Spektori i Operacioneve Doganore	3610	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
		Zyra e Skanerit	3601	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik /skaneri	C2	5	IV-a
		Zyra e Turnit A(Terminalëve Trageteve)	3602	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	8	IV-a
				Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	1	
		Zyra Turni B	3603	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	8	IV-a
				Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	1	
		Zyra e Pikës së Kontrollit	3604	Përgjegjës zyre	C1	2	III-b
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	6	IV-a
				Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	10	
		Zyra e Përpunimit të Anijeve	3606	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	10	IV-a
		Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	3607	Përgjegjës turni	C1	2	III-b
				Doganier akcize/regjime/preferenca/përjashtime	C2	10	IV-a
		Terminali i Kontenierëve	3608	Përgjegjës zyre	C1	2	III-b
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	8	IV-a
				Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	2	
		Spektori Doganor Porto-Romano	3605	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
				Përgjegjës turni	C1	2	III-b
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	18	IV-a
Totali i Degës Doganore						121	
				Kryetar dogane	A	1	III-a
				Specialist analizë risku/aposterior	C1	1	III-b
				Specialist jurist/borxhi	C1	1	III-b
				Specialist administrator rrjeti	C1	1	III-b
				Financier	C1	1	III-b
				Sekretar/arkivist/magaznier	C3	1	
				Shofer	D1	1	
				Sanitar /punonjës pastrimi	D3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	3710	Përgjegjës turni	C1	3	III-b
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	26	IV-a
		Spektori i Cargo/Regjime	3701	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik/regjime	C2	6	IV-a
Totali i Degës Doganore						44	
		Rajoni Elbasan, Peqin, Elbasan, Gramsh Librazhd, Pogradec, Korçë, Devoll, Kolonjë, Vlorë, Mallakastër, Berat, Skrapar, Kuçovë, Fier, Lushnjë, Tepelenë, Përmet, Gjirokastrë, Delvinë)	3003	Drejtor Rajonal Elbasan	A	0	
				Specialist	C1	0	
				Total		0	
				Kryetar dogane	B	1	III-a/1
				Specialist analizë risku/aposterior	C1	1	III-b
				Specialist jurist/borxhi	C1	1	III-b
				Specialist administrator rrjeti	C1	1	III-b
				Financier	C1	1	III-b
				Sekretar/arkivist/magaznier	C3	1	
				Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	3810	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
				Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	3	
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	4	IV-a
		Zyra e Regjimeve dhe Akcizës		Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
				Doganier akcize/regjime/preferenca/përjashtime	C2	4	IV-a
Totali i Degës Doganore						20	
				Kryetar dogane	B	1	III-a/1
				Specialist analizë risku/aposterior	C1	1	III-b
				Specialist jurist/borxhi	C1	1	III-b
				Specialist administrator rrjeti	C1	1	III-b
				Financier	C1	1	III-b
				Sekretar/arkivist/magaznier	C3	1	
				Shofer	D1	1	
				Sanitar/punonjës pastrimi	D3	1	



		Zyra e Operacioneve Doganore	3910	Punëtor mirëmbajtje	D2	2	
				Përgjegjës turni /përgjegjës pike	C1	3	III-b
				Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	6	
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	6	IV-a
		Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	3901	Doganier akcize/regjime/preferenca/përrjashtime	C2	3	IV-a
		Zyra e Skanerit		Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik /skaneri	C2	5	IV-a
		Zyra Doganore Tushemisht		Përgjegjës turni/përgjegjës zyre	C1	1	III-b
Totali i Degës Doganore					40		
10	Dega Doganore Korçë	Administrata	4000	Kryetar dogane	B	1	III-a/1
				Specialist analizë risku/aposterior	C1	1	III-b
				Specialist jurist/borxhi	C1	1	III-b
				Financier	C1	1	III-b
				Sekretar/arkivist/magaziner	C3	1	
				Sanitar/punonjës pastrimi	D3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	4010	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
		Doganier peshore/pikë kontrolli		C3	1		
		Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik		C2	2	IV-a	
		Përgjegjës zyre		C1	1	III-b	
		Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	4001	Doganier akcize/regjime/preferenca/përrjashtime	C2	4	IV-a
		Zyra Doganore Goricë		Përgjegjës turni/përgjegjës zyre	C1	1	III-b
		Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik		C2	3	IV-a	
Totali i Degës Doganore					23		
11	Dega Doganore Kapshticë	Administrata	4100	Kryetar dogane	B	1	III-a/1
				Specialist analizë risku/aposterior	C1	1	III-b
				Specialist administrator rrjeti	C1	1	III-b
				Specialist jurist/borxhi	C1	1	III-b
				Financier	C1	1	III-b
				Sekretar/arkivist/magaziner	C3	1	
				Sanitar/punonjës pastrimi	D3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	4110	Punëtor mirëmbajtje	D2	1	
		Përgjegjës turni /përgjegjës pike		C1	3	III-b	
		Doganier peshore/pikë kontrolli		C3	9		
		Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik		C2	6	IV-a	
		Zyra e Skanerit	4110	Doganier akcize/regjime/preferenca/përrjashtime	C2	2	IV-a
		Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik /skaneri		C2	5	IV-a	
Totali i Degës Doganore					33		
12	Dega Doganore Vlorë	Administrata	4200	Kryetar dogane	A	1	III-a
				Specialist analizë risku/aposterior	C1	1	III-b
				Specialist jurist/borxhi	C1	1	III-b
				Financier	C1	1	III-b
				Specialist administrator rrjeti	C1	1	III-b
				Sekretar/arkivist/magaziner	C3	1	
				Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	4210	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
		Doganier peshore/pikë kontrolli		C3	3		
		Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik		C2	9	IV-a	
		Përgjegjës zyre		C1	1	III-b	
		Zyra e Regjimeve dhe Akcizës	4201	Doganier akcize/regjime/preferenca/përrjashtime	C2	4	IV-a
		Zyra Doganore Himarë		Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	0		IV-a			
Zyra Doganore e Terminalit Bregdetar për depozitim e naftës dhe nënprodukteve në Gjirin e Vlorës	4202	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b		
Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik		C2	2	IV-a			
Totali i Degës Doganore					32		
13	Dega Doganore Fier	Administrata	4300	Kryetar dogane	B	1	III-a/1
				Specialist analizë risku/aposterior	C1	1	III-b
				Specialist administrator rrjeti	C1	1	III-b
				Specialist jurist/borxhi	C1	1	III-b
				Financier	C1	1	III-b
				Sekretar/arkivist/magaziner	C3	1	
				Punëtor mirëmbajtje	D2	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	4310	Sanitar/punonjës pastrimi	D3	1	
		Përgjegjës Zyre		C1	1	III-b	
		Doganier peshore/pikë kontrolli		C3	3		

				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	4	IV-a
		Zyra e Regjimeve dhe Akcizës		Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
				Doganier akcize/regjime/preferenca/përrjashtime	C2	9	IV-a
		Totali i Degës Doganore					26
14	Dega Doganore Berat	Administrata	4400	Kryetar dogane	B	1	III-a/1
				Specialist analizë risku /aposterior/jurist/borxhi	C1	1	III-b
				Financier	C1	1	III-b
				Sekretar/arkivist/magaziner	C3	1	
				Punëtor mirëmbajtje	D2	1	
				Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
	Zyra e Operacioneve Doganore	4410	Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	1		
	Zyra e Regjimeve dhe Akcizës		Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	2	IV-a	
				Doganier akcize/regjime/preferenca/përrjashtime	C2	3	IV-a
		Totali i Degës Doganore					12
15	Dega Doganore Kakavijë (Gjirokastër)	Administrata	4500	Kryetar dogane	A	1	III-a
				Specialist analizë risku/aposterior	C1	1	III-b
				Specialist administrator rrjeti	C1	1	III-b
				Specialist jurist/borxhi	C1	1	III-b
				Financier	C1	1	III-b
				Sekretar/arkivist/magaziner	C3	1	
				Shofer	D1	1	
				Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	4510	Punëtor mirëmbajtje	D2	1	
		Zyra e Skanerit		Përgjegjës turni	C1	3	III-b
		Zyra e Regjimeve dhe Akcizës		Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	9	
		Zyra Doganore Sopikë	4501	Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	12	IV-a
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik /skaneri	C2	5	IV-a
		Doganier akcize/regjime/preferenca/përrjashtime	C2	3	IV-a		
		Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	0	IV-a		
				Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	0	
		Totali i Degës Doganore					41
16	Dega Doganore Sarandë	Administrata	4600	Kryetar dogane	B	1	III-a/1
				Specialist analizë risku /aposterior/jurist/borxhi	C1	1	III-b
				Financier	C1	1	III-b
				Specialist administrator rrjeti	C1	1	III-b
				Sekretar/arkivist/magaziner	C3	1	
				Shofer	D1	1	
				Punëtor mirëmbajtje	D2	1	
				Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	4610	Përgjegjës zyre	C1	1	III-b
				Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	2	
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	2	IV-a
				Përgjegjës turni/përgjegjës zyre doganore	C1	2	III-b
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	4	IV-a
		Doganier akcize/regjime/preferenca/përrjashtime	C2	2	IV-a		
				Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	6	
		Totali i Degës Doganore					27
17	Dega Doganore Tri Urat (Përmet)	Administrata	4700	Kryetar dogane	B	1	III-a/1
				Specialist analizë risku /aposterior/jurist/borxhi	C1	1	III-b
				Financier	C1	1	III-b
				Sekretar/arkivist/magaziner	C3	1	
				Sanitar / punonjës pastrimi	D3	1	
		Zyra e Operacioneve Doganore	4710	Përgjegjës turni	C1	1	III-b
				Doganier peshore/pikë kontrolli	C3	2	
				Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik	C2	4	IV-a
		Zyra e Regjimeve dhe Akcizës		Doganier akcize/regjime/preferenca/përrjashtime	C2	3	IV-a
		Totali i Degës Doganore					15
		Totali i degëve doganore					626
		Totali i Administratës Doganore					1002



ANEKSI 1
KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE

Kategoria	Eprori i Drejtpërdrejtë	Kriteret arsimore	Kriteret profesionale	Kritere të tjera
Zyrtar i kategorisë A	Drejtori i Përgjithshëm Zv. Drejtori i Përgjithshëm përgjegjës për Departamentin	“Diplomë “Master i Shkencave/Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat ekonomike, juridike, natyrore, politike etj. Kanë përparësi kandidatët me arsim jashtë vendit dhe gradën shkencore “Doktor”.	Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë pune pa ndërprerje në një post të kategorisë B për zyrtarët që konkurrojnë nga brenda sistemit. Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë pune në poste të barasvlershme për konkurrentët nga jashtë sistemit.	Njohja e të paktën një gjuhe të huaj kryesore (anglisht ose frëngjisht) Kërkesat e vendit të punës
Zyrtar i kategorisë B	Drejtori i Drejtorisë ose Kryetari i Degës Doganore	“Diplomë “Master i Shkencave/Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat ekonomike, juridike, natyrore, politike etj. Kanë përparësi kandidatët me arsim jashtë vendit dhe gradën shkencore “Doktor”.	Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë pune pa ndërprerje në një post të kategorisë C1 për zyrtarët që konkurrojnë nga brenda sistemit. Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë pune në poste të barasvlershme me C1, për punonjës nga jashtë sistemit doganor.	Përparësi njohja e një gjuhe të huaj kryesore (anglisht ose frëngjisht) Kërkesat e vendit të punës
Zyrtar i kategorisë C1	Drejtori i Drejtorisë ose Përgjegjës i Sektorit ose Kryetari i Degës Doganore	“Diplomë “Master Profesional” apo të barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat ekonomike, juridike, natyrore, politike etj”.	Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë pune pa ndërprerje në një post të kategorisë C2, për zyrtarët që konkurrojnë nga brenda sistemit. Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë pune në poste të barasvlershme me C2, për punonjës nga jashtë sistemit doganor.	Përparësi njohja e një gjuhe të huaj, anglisht/ frëngjisht Kërkesat e vendit të punës

Zyrtar i kategorisë C2	Përgjegjës i Sektorit	“Diplomë “Bachelor” apo të barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat ekonomike, juridike, natyrore, politike etj”.	Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë pune pa ndërprerje në një post të kategorisë C3 për zyrtarët që konkurrojnë nga brenda sistemit. Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë pune në poste të barasvlershme me C3 për punonjës nga jashtë sistemit doganor.	Përparësi njohja e një gjuhe të huaj, anglisht/ frëngjisht. Kërkesat e vendit të punës
Personel doganor nivelit të ulët i kategorisë C3	Përgjegjës i Sektorit	Diplomë e shkollës së mesme	Nuk është e domosdoshme, por mund të përbëjë prioritet.	Kërkesat e vendit të punës
Personel ndihmës i kategorisë D1	Përgjegjës i Sektorit	Diplomë e shkollës së mesme	Nuk është e domosdoshme, por mund të përbëjë prioritet.	Kërkesat e vendit të punës
Personel i shërbimit të mirëmbajtjes i kategorisë D2	Përgjegjës i Sektorit	Diplomë e shkollës tetëvjeçare, si dhe çdo certifikatë/vërtetim shtesë që konsiderohet i nevojshëm për kryerjen e detyrës.	Nuk është e domosdoshme, por mund të përbëjë prioritet.	Kërkesat e vendit të punës
Personel sanitar kategoria D3	Përgjegjës i Sektorit	Diplomë e shkollës tetëvjeçare	Nuk është e domosdoshme, por mund të përbëjë prioritet.	Kërkesat e vendit të punës



UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 5668, datë 20.11.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 12.2.2009 “PËR PËRCAKTIMIN E
TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME E SHËRBIME TË ADMINISTRATËS
GJYQËSORE E MINISTRISË SË DREJTËSISË, SHËRBIMIT PËRMBARIMOR
SHTETËROR, PROKURORISË, NOTERISË DHE ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 pika 1 shkronja “ç” të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

1. Në udhëzimin nr. 13, datë 12.2.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimi Përmbarimor Shtetëror, Prokurorisë, Noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, shkronja A e shtojcës 1, zëvendësohet me shkronjën A të shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

SHTOJCA 1

**TARIFA PËR VEPRIMET DHE SHËRBIMET QË KRYHEN NGA ADMINISTRATA
GJYQËSORE, MINISTRIA E DREJTËSISË, PROKURORIA DHE NOTERIA**

		Masa e tarifës në lekë	Masa e tarifës në %
A.	Tarifa për veprime e shërbime që kryhen nga administrata gjyqësore e prokuroria:		
1	Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesa ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit	200	
2	Për lëshimin nga gjykata të çdo kopje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit	200	
3	Për lëshimin e dëshmisë së penaltetit nga zyrat e gjendjes gjyqësore	200	
4	Për legalizimin e akteve të noterisë nga Ministria e Punëve të Jashtme	200	
5	Për lëshimin e vërtetimit së ndaj shtetasit nuk është filluar çështje penale nga prokuroria	200	
6	Për lëshimin e vendimit të pushimit ose të vendimit të mosfillimit të çështjes penale nga prokuroria	200	

7	Për lëshimin e vërtetimit nga gjykata së kërkuesi nuk është në proces gjyqësor	200	
8	Kërkesëpadi që paraqiten në gjykatë:		
	a) për pension ushqimor	0	
	b) për vërtetim fakti	200	
	c) padi për zgjidhje martesë	3000	
	ç) padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike	3000	
	d) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore, si dhe për shkaktim dëmi:		
	I) me vleftë deri 100 000 lekë	3000	
	II) me vleftë mbi 100 000 lekë		1%
	dh) padi për përpjesëtim pasurie	3000	
	e) padi për kthim në punë	0	
9	Pranimi i ankimeve kundër vendimeve të gjykatës	200	

URDHËR

Nr. 1909, datë 17.10.2013

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të ndryshuar, në nenet 27, 29, 31, 121 dhe 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zëvendësministrit të Mbrojtjes, zotit Dritan Hila, i delegohet kompetenca për nënshkrimin e autorizimeve për përfaqësimin e Ministrisë së Mbrojtjes në proceset gjyqësore, të padive të ngritura nga Ministria e Mbrojtjes, të ankimeve në gjykatën e apelit dhe rekurseve në Gjykatën e Lartë, ku palë e paditur/paditëse është Ministria e Mbrojtjes.

2. Ky urdhër të dërgohet për botim në Qendrën e Botimeve Zyrtare nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Autorizimet e nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij urdhri do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

4. Ndjek dhe ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri zëvendësministri i Mbrojtjes, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Drejtoria Juridike.

5. Urdhri nr. 756, datë 17.5.2007 i Ministrit të Mbrojtjes “Për delegim kompetence”, revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MBROJTJES
Mimi Kodheli



URDHËR
Nr. 765, datë 6.12.2013

PËR RREGULLAT E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KOMITETEVE AD HOC

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 43, pika 4, të ligjit nr. 109/2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Krijimin e komiteteve *ad hoc*, pranë Ministrisë së Drejtësisë, për rekrutimin, promovimin dhe lëvizjen paralele në shërbimin civil gjyqësor.

2. Komiteti *ad hoc* ngrihet nga struktura përgjegjëse për personelin e administratës gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë.

3. Komiteti *ad hoc* përbëhet nga pesë anëtarë, si më poshtë:

a) Kryetari i gjykatës ku janë shpallur vendet e lira, në cilësinë e drejtuesit të komitetit;

b) një gjyqtar i asaj gjykate;

c) kancelari i gjykatës;

ç) një përfaqësues i strukturës përgjegjëse për personelin e administratës gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë;

d) një gjyqtar i gjykatës ose, sipas rastit apo nevojës, një pedagog i Fakultetit të Drejtësisë ose ekspert në fushën, për të cilën është shpallur vendi i lirë.

4. Për kryerjen e funksionit të tij, komiteti *ad hoc* bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve, nëpërmjet një konkurrimi të hapur, të shpallur nga struktura përgjegjëse për personelin e administratës gjyqësore, në Ministrinë e Drejtësisë. Shpallja e vendeve të lira në gjykatë bëhet me kërkesë të kancelarit. Njoftimi i shpalljes së vendeve të lira bëhet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Struktura përgjegjëse për personelin e administratës gjyqësore, në Ministrinë e Drejtësisë, vë në dispozicion të komitetit *ad hoc*, dokumentacionin e kandidatëve që kanë aplikuar për vendin e lirë.

6. Komiteti *ad hoc* i propozon Ministrinë të Drejtësisë emërimin e kandidatit të vlerësuar maksimalisht, bazuar në përvojën profesionale, publikimet shkencore dhe aftësitë e veçanta të tij. Përzgjedhja e kandidatit bëhet nëpërmjet një procesi transparent e të drejtë, si dhe duke respektuar parimet e shanseve të barabarta, të meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit.

7. Komiteti *ad hoc* merr vendime në praninë e të gjithë anëtarëve.

8. Në përfundim të procesit, anëtarët e komitetit *ad hoc* nënshkruajnë procesverbalin e hartuar nga struktura përgjegjëse për personelin e administratës gjyqësore, në Ministrinë e Drejtësisë.

9. Anëtari i komitetit *ad hoc*, i përcaktuar në shkronjën “d” të pikës 3 të këtij urdhri, përfiton shpërblim për pjesëmarrje, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Ngarkohen Drejtoria e Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, në Ministrinë e Drejtësisë, gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit për zbatimin e këtij urdhri.

11. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 48 lekë